



QËNDRESA

REXHEP MALAJ

QËNDRESA

REXHEP MALAJ
KUJTIME NGA BURGU

KUJTIME NGA BURGU

Shënim: Kujtimet janë shkruar nga **Rexhep Malaj** gjatë vuajtjes së dënimit **në burgjet famëkeqe të ish-Jugosllavisë**, në periudhën **1975-1983**.

“

Njerëzit e shtëpisë më përcollën me grushtin lart. Taman si përcillet luftëtari i lirisë për në luftë. Paj, edhe unë në luftë shkoja; në luftë me bisha që kanë pamje njeriu. Më futën në një makinë të policisë, para dhe prapa së cilës kishte makina të tjera përplot policë të armatosur.

”

“

Fundi ishte akoma larg, shumë larg. Kisha dëgjuar se pak njerëz kishin mundur t'u qëndronin torturave të këtyre përbindëshave me pamje njeriu. Isha i vetëdijshtëm për pafajësinë time, por edhe i dhashë vetes për detyrë të qëndroja gjer në fund, të mos tradhetoja, të mos kallëzoja askënd dhe me asnjë çmim të mos i pranoja akuzat e tyre. Duhej t'ju jipja shembull edhe të tjerëve që do të vijnë pas.

”

ISHTE DIMËR I FTOHTË...

Ishte dimër i ftohtë, kur një mëngjes herët, policët, si lukuni ujqërish kishin rrethuar shtëpinë time. Ishin të armatosur me pushkë e automatikë. Kishin zënë pozita luftarake, të gatshëm për të shtënë në ne, në lëvizjen më të vogël. Që të gjithë qemë në gjumë, kur papritur filluan të kërcasin në dyer, iu mëshonin sa mundnin me duar e shqelma. Nuk prisnin as të vishemi. Posa u çelën dyert, u vërsulën si bisha të qartura dhe me armët gati dhe na shpërndanë nëpër dhoma. Filloi një bastisje sa rrënuese aq edhe e poshtër. Ishin shumë dhe nuk mund të përcillnim se mos na vidhnin gjë. Rrotulluan e përmbysën çdo gjë që patën përpara. Qirreshin si egërsia të uritura. Donin të fushnin tmerr e panik te njerëzit e shtëpisë, por dështuan, sepse anëtarët e familjes sime e morën këtë si një gjë të rëndomtë. Ata ishin mësuar me arrestime që nga gjyshi e stërggjyshi. Për ne nuk ishte e para herë që arrestohej një anëtar i familjes. Udbashët me vegla e aparate gjurmonin, si qentë edhe në kantën e bërlllogut se mos gjenin gjë. Pas disa orësh rrotullimi e përmbysjeje, si duket e panë se po lodhen kot, prandaj m'i vunë prangat që në dhomë. Njerëzit e shtëpisë më përcollën me grushtin lart. Taman si përcillet luftëtari i lirisë për në luftë. Paj, edhe unë në luftë shkoja; në luftë me bisha që kanë pamje njeriu. Më futën në një makinë të policisë, para dhe prapa së cilës kishte makina të tjera përplot policë të armatosur.

Para dyerve të UDB-së më nxorën nga makina dhe të rrethuar nga të gjitha anët më futën brenda. Më çuan në zyrë, mu aty, ku do ti zhvillonin hetimet ndaj meje. Aty më bënë një bastisje detale; më zhveshën lakuriq, të poshtrit! Thua se nuk më kishin bastisur kur m' i vunë prangat në shtëpi. Tërë ditë më mbajtën në atë dhomë. Gjer në orët e vona të natës.

Askush s'më pyeste gjë.

Edhe më parë më kishin arrestuar për ndonjë ditë, por ia nisnin menjëherë nga pyetjet, kurse tani jo. Një polic nisi ta luajë rolin e njeriut të mirë duke më këshilluar: "Trego çfarë të dijshe dhe puna do të mbarojë me kaq, sepse këta do të të mendojnë, do të të rrafinojnë dhe do të të torturojnë. Mos e shkatërro shëndetin se je i ri. Nëse do, thuami mua të gjitha ato që i di dhe unë do të të lëshoj që sonte të shkosh në shtëpi... I thashë se nuk dija asgjë, madje as për çka më kishin arrestuar. Ai nuk më ngacmoi më. Një polic, që të nesërmen do të mësoja se ishte hetuesi im kryesor, kur hyri brenda më pyeti: "Ti je Shpëtim Guri a ?" Po, i thashë. Duke u zgërdhirë si qen më tha: "Nëna në shtëpi e bën miellin bukë, e ne këtu e bëjmë bukën miell! Mbaje mend këtë!" Qeshi me fjalët e veta si i marrë dhe iku. M'u kujtuan fytyrat e gestapos hitleriane që kisha parë në filma. Kurrëfarë dallimi nuk kishin prej tyre kriminelët e UDB-së. Siç mësova më vonë ky ishte gjakpirësi Asllan Sllamniku.

Kaq biseduan me mua ditën e parë. Policët ndërroreshin vazhdimisht, gjersa më në fund, rreth orës 23, më dërguan në burg.

U kryen formalitetet rreth pranimit tim dhe nëpër korridorin e ngushtë të burgut më dërguan në birucë, siç i thonë ndryshe qelisë. Aty s'kishte asgjë tjetër veqse një teneqeje me ujë dhe një qypi që quhej "kibëll" dhe që shërbente në vend vc-je. Gardiani më dërgoi në qoshk të korridorit, ku ishin dy dyshekë të vegjël, të shkyer e të ndyrë sa s'bëhet sa vetëm emri dyshekë u kishte mbetur. Ishin edhe të përgjakur, sigurisht nga ndonjë i burgosur i torturuar. Kishte edhe dy "qebe" (batanie) të grisura, të pluhurosura e të fëlliqura. Edhe këto ishin të gjakosura.

"Merri!" - urdhëroi gardiani. Ç'ti bësh, më duhej t'i marr. Në atë natë të ftohtë, më mirë me to se pa hiç gjë. Posa hyra brenda në qeli u përplas dera pas meje, ndërsa shuli kërciti me tërsëllimë. "Kështu kërcitkan shulat e dyerve të burgjeve jugosllave!" - mendova me vete. Më duhej të mësohesha edhe me këtë, që tani e tutje për shumë vjet do të ishte pjesë e jetës sime.

Policia jugosllave, si çdo polici fashiste e antipopullore, ndjek e persekuton çdo patriot e revolucionar. Nga pamundësia për t'i zbuluar atdhetarët që luftojnë e verpojnë natë e ditë, kudo në Kosovë, UDB arreston njerëz të pafajshëm e liridashës, i torturon me metodat me shtazarake për t'i detyruar t'i pranojnë gjërat, të cilat as ëndërr s'i kanë parë e pastaj i hedh në gjyq dhe u shqipton dënime të rënda. Ndiqen sidomos simpatizantët e

Lëvizjes, nga frika se sot apo nesër mund të inkuadrohen aktivisht në të. Dikush mund të pyes se si policia mund t'i dijë simpatizantët e Lëvizjes. Fare thjeshtë. Serbomëdhenjtë janë të vetëdijshëm se populli ynë është i ndërgjegjshëm për gjendjen ku e ka katandisur politika e tyre fashiste. Populli shqiptar është i pakënaqur me pozitën e tij prej populli të shtypur në Jugosllavi. Ai në këto kushte nuk sheh tjetër rrugë veç asaj të qëndresës, përmes së cilës duhet t'i realizojë aspiratat e tij historike. Prandaj s'është vështirë të gjesh bazën e dyshimit serbomadhi ndaj popullit tonë në përgjithësi.

Kështu, që nga bankat e shkollës fillore ndiqet e përcillet puna dhe sjelljet e çdo shqiptari në Jugosllavi. Pastaj mjafton që një pjesëtar i farefisit të kete qenë në burg që edhe ti saora të figurosh në dosjen policore si kandidat potencial për ndjekje nga UDB jugosllave.

Meqë bastisjet e shqiptarëve janë gjëra fare të rëndomta, mjaftojnë të gjejnë ndonjë libër të ndaluar, e këso këtu ka shumë..., ndonjë broshurë, fletushkë apo gazetë ilegale, ku flitet për problemet jetike të popullit ose ndonjë trakt apo afishe të shpërndarë nga Lëvizja apo fotografi të nxjerrë nga gazetatat që kanë të bëjnë me realitetin në Shqipërinë nënë dhe të të fusin në burg, të torturojnë e mendojnë të tregosh atë që ta ka dhënë apo që e ka shpërndarë dhe, bashkë me të të hedhin në gjyq dhe të dënojnë me vite të tëra. Gjëra për të cilat njeriu në botën e civilizuar as që guxon të merret në pyetje. Ndodh kështu sepse drejtësia dhe humanizmi ka kohë që kanë humbur, veçanërisht ndaj shqiptarëve, kuptimin e tyre në Jugosllavi.

Prandaj as nuk bëra ndonjë përjashtim. Rashë në sy që nga bankat e shkollës fillore si lirimdashës, sepse doja popullin tim, historinë e tij të lavdishme, sepse doja Kosovën time dhe simpatizoja me gjithë shpirt Shqipërinë. Dhe u mjaftoi kjo të më fusin në burg. Më mirë ta kemi nën dry se sa të mundohemi duke e përcjellur, kështu sigurisht rezonoi logjika e sëmurë e UDB-së.

Qelia ku më futën ishte e vogël sa s'bëhet; aq sa nuk mund i shtrija këmbët sa duhet. Tavani ishte i ulët sa që kur ngrihesha e prekja edhe me dorë. Gjatësia e mureve nuk ishte e rregullt, sepse burgu ishte në formë rrethi. Tri të katërtat e rrethit ishin burg, ndërsa pjesa tjetër përbënte ndërtesën e UDB-së, një japi tri-katër katëshe, mbi 100 metra e gjatë. As lartësia e mureve të burgut nuk ishte e njëjtë, pasi që nuk kishte kulm, por një pllakë të pjerrët plumbi e betoni. Dritarja ishte shumë e vogël nga jashtë kishte një xham

tjetër të trashë e të errët të larguar nga muri për 25-30 cm. Nga fundi i kësaj plase mund ta shihja pakëz qiellin, por kurrë diellin. Kuptohet mes dy dritareve ishin grilat e hekurta. Me hekur e beton ishin edhe muret e tavanit. Bënte ftohtë sa s'ka. Qelia kundërmonte erë qelbësire. Aty kishte buba të vogla e të mëdha aq shumë sa kurrë s'mund t'i zhdukje.

U mbështolla disi me të dy "çebet", por të ftohtit më kishte hyrë në palcë. Edhe pse isha pa ngrënë dy ditë dhe bënte shumë ftohtë, lodhja bëri punën e saj dhe shpejt më zuri gjumi. Të nesërmen, herët dëgjova një cingërimë të zgjatur zileje, që ishte shenjë për t'u zgjuar. Pak më vonë kërciti dryri i derës sime dhe rrapëllima e shulit. Me të bërëtitura e ngërmime një gardian më urdhëroi që dyshekët i paloja në çoshk, duke m'u ngërmuar se gjatë ditës është rreptësisht e ndaluar çdo ulje apo mbështetje në dyshekë, ndërsa "çebet", sipas rregullit, m'i qiti në korridor. Pra, gjatë ditës duhej të ulesha vetëm në dërrasat e kalbura të qelisë, që ishin të ftohta sa s'bëhet, pasi që nën to kishte beton. Dritarja nuk mbyllej si duhet dhe binte nga veriu. Mund të merret me mend se ç'të ftohtë bënte. Në mur ishte e varur një letër. Ky ishte "Rendi shtëpiak" i burgut, ku ishin edhe të drejtat që i takonin të burgosurit. Çfarë ironie ! Më vonë do të provoja me mijëra herë se ky ishte vetëm formalitet cinik, sepse në praktikë i burgosuri nuk kishte kurrëfarë të drejtash, sidomos i burgosuri politik, i cili ishte nën mbikqyrjen e përhershme të policisë politike, pa lejen e së cilës nuk i jepej as ujë. Pas pak ma sollën mëngjesin. E çfarë mëngjesi se! Vetëm ujë të nxehtë, të turbullt nga kafja. S'kishte kurrëfarë shije, s'kishte as sheqer. E shijova, por u detyrova ta derdh në qyp- kibëll. Bukë në mëngjes nuk jepnin. Vetëm në drekë të sillnin gjysmë buke dhe ti haje kur të duash gjatë 24 orëve! Pastaj më nxorën gjer te wc-ja. Duhej pastruar qypin dhe duhej marrë ujë për 24 orë. Aty kishte edhe lavabo, ku mund të pastroheshin duart. Gjatë kohës, gjersa taja qypin dhe mbushja ujë, derën ma mbyllën me shul, sikur që mbyllej edhe qelia. Nuk vonoi dhe më morën e më quan në UDB.

Hetimet ndaj meje edhe formalisht filluan. Kisha dëgjuar se në UDB më parë fillojnë nga lutjet dhe premtimet bashkë me kërkesën për bashkëpunim, dhe vetëm pasi nuk t'ia arrijnë qëllimit do të fillojnë me kërcënime e tortura. Prandaj rrija pak më sh lirë. Mendoja që t'i shoh se si i bëjnë këto paraloja para torturave. Por filloi krejtësisht ndryshe.

Isha ulur në një karrigë pranë derës dhe në dhomë ishte një polic. Hyri hetuesi kryesor me dy-tre policë prapa. Meqë unë nuk ngritesha në këmbë kur hynin e dilnin policët, nuk

u ngrita as para këtyre. Hetuesi kryesor Asllani, erdhi pranë meje edhe sikur të ishim miq më goditi lehtas më grusht në shpatullën e djathtë. Mendova: ç'bën ky njeri kështu? Mos don të bëhet thua se është shoku im, por të menduarit ma ndali një shuplakë prapshtë, ne e quajmë "magjupisht". Ishte e rëndë që sytë xixa më nxorën. Meqë reagoja në këtë të rënë, më mbërtheu për flokësh dhe, duke mos më lënë të ngritesha nga karriga, filloi të më sjellë me dorën që e kishte të lirë.

Ndërsa policet tjerë rrinin gati për çdo eventualitet. "Nuk po qohesh në këmbë, kur po hy unë brenda, a? Dije se këtu nuk je të shtëpia, por në UDB! Duhet të ngritesh në këmbë për çdo kënd kur hy brenda më tha i poshtri Asllan dhe më urdhëroi të ulesha e të ngritesha. Ia filluan pra me kërcënime edhe me të rënda që unë të flisja nga frika, edhe ata të kryenin shpejt punë me mua. Ishin keto të renat e para, sikur një racion para drekës së majme. Më vonë do të shihja se keto s'ishin asgjë nga ato që do të vinin më pas. Çdo pyetje u përgjigjesha me: nuk e di, jo; skam parë; s'kam dëgjuar; s'e kam bërë as ate, as këtë etj, etj." Më mbajtën gjer kah ora 14 e 30 dhe më quan në burg. Edhe kur më merrnin në burg për hetime (lexo: torturime) dhe kur më kthenin në qeli m'i vënin prangat, edhe pse burgu, siç thashë, ishte i ngjitur me UDB-në.

Në qeli më priste pasuli i ftohtë (pasul i thonin se ishte i tëri ujë me vetëm disa kokrra pasuli) dhe buka. Kishte 48 ore që s'kisha ngrënë fare. Dhe e hëngra tërë bukën që ma kishin sjellur edhe pse ajo ishte për 24 orë.

S'vonoj as një orë pas drekës dhe më morën prapë në UDB. Tani kishin ardhur 4-5 hetues. Në përgjigjen time të parë "nuk e di" kërciti grushti në barkun tim, më ranë me shqelm, filloi njëri të më bjerë duarve e pastaj trupit. Pasi u lodh, punën e tij e vazhdoi tjetri. Nga të renat fytyrës, m'u qanë buzët dhe më shpërtheu gjaku për hunde e goje. Nuk më linin as të merrja frymë. Më quan shpejt e shpejt në tualet të më pastronin gjakun nga fytyra e rrobat dhe më kthyen prapë. Më rrëzuan në dysHEME, më urdhëruan të zbathi këpucët dhe qorapet. "Ta shohim tash në fallak se si do të përdridhet"- tha hetuesi. Menjëherë e kuptova. E dija se ç'është fallaku. Këtë metodë e kishin përdorur që në kohërat e lashta dhe inkuizicionet e kishës. Filluan të më binin në shputat e këmbëve sa mundnin. Njëri më mbante për krahësh, e tjetri ishte hypur mbi mua dhe godiste me tërë fuqinë e tij shputave të këmbëve të mia. Kjo ishte edhe për ata një punë e vështirë fizike, edhe pse e bënin me ëndje të posaçme.

Lodheshin dhe shkumbinin si kuajt. Por, ata kishin një përparësi, sepse sa lodhej njëri, menjëherë e zëvendësonte tjetri, dhe kështu me radhë. Në dy mënyra më goditnin shputave, ndonjëri më binte vetëm në njëren këmbë nga 15-20 "pendrekë" e pastaj po aq në tjetrën, e prapë këmbës tjetër dhe kështu gjersa lodheshin. Ndonjë tjetër më binte me radhë një herë në njëren e herë në tjetrën, gjersa lodhej. Kjo e dyta më dukej më e lehtë. Këtë gjë sigurisht se e dinin edhe ata, prandaj më goditnin here në një mënyrë e herë në një tjetër.

S'mbaj mend të ketë ndodhur që dy vetë radhazi të më goditnin në një mënyrë. Kohë pas kohe, e sidomos kur e ndienin veten të lodhur më urdhëronin të ngritesha e të shëtis nëpër dhomë. Ishin këto mundime të mëdha të ecësh me shputa të enjtura e të goditura pa mëshirë sikur të ishin cunga me mish njeriu. Kur nuk ngritesha, më ngritnin me shqelma e kërbagë. Dhe prapë në fallak. Prapë shëtitje nëpër dhomë, të rëna duarve me "pendrekë", të rëna të forta me të dy duart në veshë përnjëherë, nga të cilat edhe sot më dhëmbin veshët. Të vetmin pushim e kisha kur pushonin edhe vetë xhelatët. Dhe kështu vazhdimisht gjer në orët e vona të mbrëmjes. Në ndërkohë, nga bisedat e hetuesve mes veti, kuptova se kishte edhe të burgosur tjerë me mua.

Në qeli më priste pjata me makarona të ftohtë dhe pa pikë yndyre. Kuptohet, bukë nuk kishte. Pjesën e bukës që ishte për 24 ore e kisha ngrënë në drekë. Makaronat nuk haheshin, s'do t'i kishin ngrënë as derrat e uritur, aq shumë kuntërbonin. Drita ishte fikur, s'kishte kohë të mendohesha, më duhej të pushoja, por trupin e kisha të dërrmuar nga grushtet dhe "pendrekët".

Këmbët më dhimbnin si drita e syrit. Ishin enjtur aq shumë sa as kepuçet nuk mbatheshin dot më. Nuk di as si kam ardhur gjer te qelia. Kam ardhur vetë apo më kanë terhequr për krahësh. Isha krejt i dërrmuar vetëm mendjen e kisha të kthjelltë dhe e dija se si po veprojnë me mua, por krejt kjo ishte vetëm fillimi. Fundi ishte akoma larg, shumë larg. Kisha dëgjuar se pak njerëz kishin mundur t'u qëndronin torturave të këtyre përbindëshave me pamje njeriu. Isha i vetëdijshëm për pafajësinë time, por edhe i dhashë vetes për detyrë të qëndroja gjer në fund, të mos tradhetoja, të mos kallëzoja askënd dhe me asnjë çmim të mos i pranoja akuzat e tyre. Duhej t'ju jipja shembull edhe të tjerëve që do të vijnë pas.

“

Dhe kam të drejtë të tregoj për trajtimin shtazarak të policisë fashiste jugosllave ndaj meje, ta çjerri maskën false të shoqërisë "demokratike" e "humanitare" që e propagandojnë me aq bujë e që në realitet s'ekziston kurrëfarë nuance demokracia në këtë sistem të dështuar që mbështetet kryesisht në dhunën policore.

”

NË DUART E SPECIALISTËVE MONSTRUOZË TË UDB-së

Filluan kështu torturat shtazarake të policisë fashiste jugosllave. Këta nuk ishin hetues, por bisha, që s'kishin kufij në shfrenimin e ndjenjave shtazarake, ishin si ujqër të uritur për mish njeriu; të etur për të pirë gjak. Është fakt se kishte hetues që i thoshin vetes "shqiptarë". Ishin këta tradhtarët më të fëlliqur të popullit tonë, të cilët kryenin punët më të poshtra. Hetimet i udhëhiqte një shovinist serb, i specializuar për torturat më çnjerëzore, dhe vetëm formalisht ishin vën hetues "shqiptarë". E pse jo? Kjo duhet për propagandën e tyre të ndyrë se gjoja në UDB punojnë shqiptarët, dhe nëse do të akuzoheshin nga opinioni botëror për terror e reprezalje ndaj shqiptarëve prapë do të fajësoheshin shqiptarët se ata punokan në UDB. Në kthinat e kësaj UDB-je kishin vdekur, siç vdesin edhe sot shumë patriotë shqiptarë nga torturat dhe gjatë tyre. Por specialistët e ndyer për krimet monstruoze, gjithmonë do të kujdesen dhe do të gjejnë mjekë që do të nënshkruajnë se nga ajo apo nga kjo sëmundje ka vdekur i burgosuri. Mjeku patriot shqiptar Ali Sokoli, specialisti i sëmundjeve të mushkërive ishte ndër ata mjekë të rrallë që qysh atëherë mund të bëjë ballë presioneve dhe me guxim tu kundërvihet kercënimeve të UDB-së për të nënshkruar se patrioti i pavdekshëm Fazli Grajçevci, vdiç nga mushkëritë e sëmura!

Edhe pse UDB-ja do të gjente mjek tjetër për të dhënë një diagnozë të tillë, populli do të mësojë shumë shpejtë për torturat shtazarake dhe qëndrimin heroik të Fazli Grajçevcit por edhe për qëndrimin revolucionar të mjekut Ali Sokoli.

Me tepër se një muaj më merrnin në pyetje dy herë në ditë, para dite dhe në mbrëmje, pos të dielës që me gezim e pritsha si pushim. Të torturohet njeriu një kohë kaq të gjatë dy herë në ditë, kjo zor të shihet e të degjohet. As në Gestapon hitleriane nuk i kanë torturuar kaq gjatë.

Pastaj, është fakt se mua nuk më kanë torturuar aq sa kam dëgjuar se i kanë torturuar të tjerët më parë. Por edhe neve nuk na kanë lënë keq në këtë aspekt. Në këtë kohë me tortura intensive, nga dy herë në ditë, çdonjërit prej tyre po iu kishte lënë në dispozicion të zgjidhte torturat apo plumbin, pa hamendje do të zgjidhnim këtë të dytin. Edhe të shpëtonin nga torturat dhe të dilnin faqebardhë, sepse nga torturimi i parreshtur kishte njerëz që do të thyeshin edhe përkundër qëndresës kembëngulëse. Tërë kohën sa më mbanin në kthinat e UDB-së, 8-12 orë në ditë, kurrë s'më linin të ulesha në karrigë e as të mbështetesh në mur. Më ulnin në karrigë vetëm atëherë kur ma futnin lapsin me zor në dorë dhe më urdhëronin të shkruaj për gjërat që s'i kisha as në ëndërr. Kërkonin i identifikoj njerëzit që nuk i njihja fare dhe të them se ai është person që ka shpërndarë afishe apo që më ka dhënë material propagandistik për të lexuar. Kërkonin t'i pranoja aksionet që s'i kisha kryer dhe as që kisha lidhje me to. Kërkonin të pranoja se kam lexuar këtë apo atë libër të ndaluar, këtë broshurë, fletushkë, gazetë ilegale apo trakt e afishe të shpërndarë. Kur më ulnin në karrigë më rrinin një para, një prapa shpinës dhe dy anash. "Shkruaj", më bërtitnin, dhe posa përgjigjesha "s'kam çka të shkruaj" më kërcitnin grushtet, shuplakat, pendrekë dhe shqelmat nga të gjitha anët. Atëherë shkruaj për këto që po të themi ne, gërvalleshin udbashët dhe posa përgjigjesha se "ato nuk janë të vërteta" më binin me tërë fuqinë me kërbaz duarve, të cilat më parë m'i patën shtrirë në tavolinë.

Ata: "Shkruaj kush ka mundur ta shpërndajë këtë afishe!" Unë: "Nuk e di...". Aq të poshtër e këmbëngulës ishin sa më thoshin se edhe derr të zi do të pjellësh, se çare s'ke pa treguar. Si të duash, nëse do dajak, dajak do të japim; ne kemi kohë dhe s'po na ngut kush. Nëse s'do të flasësh ne do të mendojmë kësisoji 9 muaj dhe ti nëse i qëndron të lumtë. Deri sot kurrkush nuk qëndroi e, qebesa s'do të qëndrosh as ti, se nuk më thonë kot "specialisti Asllan Sllamniku", dhe më binte me të dy duart përnjëherë veshëve.

Torturuesit kryesorë ishin dy-tre serbë, që emrat s'mund t'ua dijë, pasi që ishte e pamundur t'ua mësoja. Në UDB ishte një praktikë që shqiptarët-hetues i thirrnin me emra

serbë, e serbët me emra shqiptarë. Mund të mësoje, për shembull se njëfarë Lorenci e thirrnin Llaze, kurse njëfarë Draganin e thirrnin Ramush. Ishte kjo një metodë pune për të mos u identifikuar torturuesit nga ana e viktimave të tyre. Ai kryesori ishte një njeri i madh me trup, me kokë të madhe si derri, fytyrën e kishte vrarëlie me dhëmbë si të kalit. Tamam kriminel, specialist për tortura. Ata vinin vetë kur bëheshin torturat më të mëdha dhe më intensive, tjerë torturues ishin edhe: Faik Nura, Muharrem Dana, Bashkim Bora e shumë të tjerëve që s'mund t'ua mësoja emrat.

Fytyra m'u pat enjtur dhe bërë mavi nga të rënat. Buzët i kisha të çara dhe nga çdo e rënë shpërthente gjaku. Duart dhe këmbët të enjtura sa s'bëhet, sa që të s'mund të mbathja as këpucët dot, e në UDB shkoja me papuçe. Kur kërkoja që të shihte dhe të më kontrollonte mjeku, refuzonin si të tmerruar. Kur më torturonin e linin derën pakëz çelë. Në fillim nuk e dija pse, por më vonë e kuptova. Donin që torturimin ta dëgjonin edhe të burgosur të tjerë në lokale të UDB-së. Na torturonin me radhë. Kështu, gjersa torturohej njëri, të tjerët merreshin në pyetje nga ndonjë udbash, kuptohet edhe dyert e tyre l linin pakëz të çelura që të dëgjonin të rënat e shuplakave, grushtave e kërbaceve dhe bërtima e atij që torturohej. Të gjithë hetuesit dhe policët tjerë, 6-7 vetë, ishin në dhomën ku torturohej i burgosuri, dhe të gjithë me radhë ose edhe bashkarisht merrnin pjesë në torturimin. Të burgosurve tjerë u mbetej që të dëgjonin dhe të prisnin secili radhën e tij. Nuk kishte gjë më prekëse e më trishtuese se sa kur dëgjoheshin gjëmat e shokëve. Dhe kështu shkonin prej një të burgosuri te tjetri duke shfryrë ndjenjat shtazarake dhe gjithë mllëfin e tyre personal mbi ne.

Më binin duarve aq sa duart nuk qëndronin dot më, dhe për të mos më lënë të pushoja ma mbanin dorën vetë dhe më goditnin parreshtur. Kur lodheshin duke m'i mbajtur duart, atëherë nga mllëfi më goditnin ku të mundnin nëpër trup. Pastaj prapë në fallak. Posa lodhej njëri e zëvendësonte tjetri menjëherë. Më kapëshin me të dy duart për flokësh dhe ma përplasnin kokën për muri. Në këto momente torturuesit e nxitnin njëri tjetrin. Shtazaraku Aslan Sllamniku, bëhej gjoja human, dhe i thoshte atij që më përplaste kokën për muri: "Mos kokën, kij kujdes se mos po e lëndon", kuptohet me sy ia bënte të më godasë edhe më shumë. Dhe ky përgjigjej: "Pse kujdes? Këtyre duhet t'ua çajmë kokën" dhe më përplaste kokën edhe më tepër. Më kapnin për organe gjenitale dhe më bërtisnin në fytyrë: Kemi me të tredhë dhe më shtrëngonin gjersa alivanosesha. Ujin e mbanin çdo

herë gati, që kur të më binte të fikët të më hidhnin ujë fytyrës dhe trupit, dhe menjëherë do të vazhdonin punën. Më fyenin me sharjet më të ndyra, më ofendonin, më përqeshnin, më pështyenin. Ishin këto poshtërime të rënda, por e dija se duhej ti duroja. Dhe, në veten time mbushesha me urrejtje të shumëfishuar për këtë regjim fashist e terrorist. Dhe kam të drejtë të tregoj për trajtimin shtazarak të policisë fashiste jugosllave ndaj meje, ta çjerri maskën false të shoqërisë "demokratike" e "humanitare" që e propagandojnë me aq bujë e që në realitet s'ekziston kurrëfarë nuance demokracia në këtë sistem të dështuar që mbështetet kryesisht në dhunën policore.

“

Pa shëtitje dhe pa literaturë e gazeta, pa asnjë njeri në qeli për të këmbyer një fjalë dhe nën presionin e përhershëm të torturave më shtazarake ishte bukur e vështirë të përballojë njeriu, por të merremi vesh, nuk ishte punë që s'bëhet, sepse njeriu i fortë me besimin e patundur në idealin e tij i përballon të gjitha.

”

IDEALI IM MË NGROH DHE MË JEP FORCË

Edhe gardianët e burgut famëkeq të Prishtinës ishin të zgjedhur dhe të ushtruar për trajtim brutal të të burgosurve politikë. Në orët e vona të një nate kur më kthyen nga torturimet, nuk isha në gjendje i kapja me duar batanijet dhe i thashë gardianit që më qoi në qeli, nje djalë i ri si unë, që të m'i hedh "çebet" në duar, sepse vetë s'kisha mundësi i kapja, sepse gishtërinjtë m'i kishin shtypur ndër tortura."Merri vetë", m'u përgjegj gardiani! Duke mbledhur forcat e fundit mezi i tërhoqa batanijet dhe i futa disi në qeli. Shumë të dresuar këta qenerojë! Të mjerët. Nuk kuptojnë çfarë lodrash të pergjakshme të të huajit që janë. Meqë bënte ftohtë i madh, pata arritur ta vjedh një copë batanie të vjetër, duke shfrytëzuar rastin, kur gardiani u detyrua të ngrit receptorin e telefonit. Ishte rrezik të më shohë, por nevoja më shtyri të rrezikoj.

Mirëpo pasi që çdo herë nuk isha në qeli, pra kur isha në UDB, apo në nevojtoe gardianët hynin në qeli dhe bënë bastisje detale. Unë mundohesha që të fsheh gjysmën e batanijes në dyshek, por njëri e kishte zbuluar "fajin" tim dhe më kishte denoncuar ne UDB, kështu që kur më kthyen në qeli më mori me brutalitet dhe duke u çjerrë tha: "Ty s'të takon çebja, bile edhe këto që t'i kanë dhënë i ke tepër!"

Pas më tepër se një muaj filluan të më mernin në pyetje dhe të më torturonin vetëm mbrëmjeve, pos ndonjë përjashtimi, intensiteti i torturave ishte i njëjtë, pos që edhe të shtunave nuk më merrnin fare. Tani i kisha nga dy ditë në javë pushim.

Kishte të burgosur që s'kishin mundur t'u qëndronin torturave dhe ishin thyer. Kishin pranuar të deponojnë gjëra çfarë u kishin thënë hetuesit, dhe i kishin nënshkruar deklaratat shpifëse e vetakuzuese. Deponimet e tyre me dorëshkrimin dhe nënshkrimin e tyre m'i sillnin dhe m'i tregonin bile edhe m'i jepnin t'i shoh nga afër. Duke hasur në pathyeshmërinë time as me deponimet e nënshkruara nga vetë të burgosurit, ata përdorën edhe kartën e fundit: ballafaqimin. Mendonin se po të me thoshte ndonjë nga te burgosurit (të cilët edhe i njihja), se kisha bërë këtë apo atë pune, se kishte kryer bashkë me mua këtë apo atë detyrë, se i kisha dhënë për të lexuar ndonjë libër apo gazetë të ndaluar, etj., unë do të thyhesha dhe do t'i pranoja deklaratat e diktuar nga udbashët dhe përdhunshëm të nënshkruara nga të torturuarit. Më ballafaquan me një të burgosur. Me atë rast salla që mbushur plot udbashë për t'i përcjellë reagimet e mia. Kur i hodha poshtë deponimet e të burgosurit u tërbuan fare. Thashë se do të më shqyejnë, aq keq më mbërthyen dhe me goditën duke bërtitur: "More gomar, more idiot, në sy te dëshmoi para të gjithë neve dhe thua se nuk është e vërtetë. Vetë ai kërkoi të ballafaqohet me ty e ne e sollëm dhe ti tani na nxjerr bishta!" Por unë isha këmbëngulës dhe vazhdova në timen, se s'ishte e vërtetë çfarë thoshte deponuesi i këtyre dëshmime të rrejshme. Si ujq të uritur m'u leshuan, kush me kërbaç e kush me grushte e me shqelma. Nuk besoja se do të shpëtoja i gjallë. Isha i përgjakur dhe i tëri i dërrmuar. Atë natë më patën quar për krahësh në qeli, edhe pse isha në gjendje disi të ecja edhe vetë, pastaj më sollën të burgosurin për t'u ballafaquar dhe për të më thënë se kisha bërë këtë apo atë pune me te, se unë njihesha me filan personin etj. I hodha poshtë me indinjatë edhe shpifjet e përdhunshme edhe të këtij të burgosuri, sepse e dija mire: se ai dëshmitar i shkretë ka kaluar nëpër të gjitha Keto që po kaloj edhe unë, prandaj është detyruar ndër tortura të akuzojë veten dhe mua.

Bile një fjalë që ai e përmendte vërtet e kisha dëgjuar, por edhe këtë e mohova me këmbëngulje. Egërsimi dhe terbimi i hetuesve barbarë s'kishin kufij, kështu që më torturuan me shumë se asnjëherë më parë. Më thoshin: "A të tha në sy se ti njihesh me filan personin?" Unë pergjigjesha: "Kjo që po thuani ju dhe ai, nuk është e vërtetë..." Ata duke më rënë: "Për ty të gjithë po genjejnë a?" Unë: "Ai dhe shumë si të tjerë nga torturat tuaja poshtëruese janë të detyruar të thonë gjëra që ju ua diktoni..." S'mund të merret me mend terbimi i tyre.

Në këto situata edhe pse të vështira sa s'bëhet, për mua ishte një kënaqësi e veçantë kur i shihja të tërbuar nga inati duke shkumbuar si qentë e çartur. Shpesh më ndodhte edhe të buzëqeshja ani boll me zor, buzët i kisha krejtësisht të çara. Çdo buzëqeshje, natyrisht më kushtonte shtrenjtë, por mjaftohesha me tërbimin e tyre. Kishin kaluar gati tre muaj hetime dhe tortura intensive për çdo ditë. Por pas ballafaqimeve intensiteti i torturimit filloi të bjerë. Tani më merrnin në pyetje dy ose tri herë në javë. Edhe torturat ishin më të pakta. Pas një kohe, kur kishin kaluar afërsisht katër muaj, filluan të më marrin në pyetje vetëm një herë në javë. Më vonë edhe këtë e rralluan, por nganjëherë më thërrisnin për nënshkrimin e procesverbalit të hetimeve, edhe pse ato ishin kryesisht mohuese. Gjatë kësaj procedure të nënshkrimit provuan për të fundit herë të më mashtrojnë në lidhje me disa persona, por as këtu nuk u përkula dhe qëndrova në deklaratën time të dhënë më parë. Për disa çështje, edhe pse nuk kishin fare të bëjnë me mua, mora përgjegjësinë mbi vete, vetëm e vetëm që ti shpëtoja disa persona për të cilët interesohej UDB dhe mezi priste ti burgoste.

Përveç torturave fizike UDB përdorte parreshtur edhe torturimin psikik. Më shanin, më fyenin, më kërcënonin se do të më mbysnin, më pështynin, më përbuznin; më kërcënonin me burgosjen e anëtarëve të shtëpisë; me largimin nga puna të atyre anëtarëve që punonin, me konfiskimin e pasurisë, por torturat e presionet e kësaj natyre m'i bënin përmes personelit të burgut.

Burgu i Prishtinës është një ndër burgjet më famëkeq që kam parë dhe, njëmend vështirë të besohet se në Evropën e qytetëruar mund të ketë labirinth të tillë. Pamja e tij do të tmerronte opinionin. Mjafton ta shikojë dikush këtë qymez udbesk për tu kuptuar në esencë politika diskriminuese shfarosëse serbomadhe në Kosovë. Burgu është në formë të një rrethi të mbyllur, në atë mënyrë që njëra prej anëve të tij mbyllet me ndërtesën e UDB-së. Ai ka dy kate: Përdhesin dhe një kat tjetër. Ka dy krahë, të djathtin dhe të majtin, të cilët janë të barabartë dhe ndahen nga shkallët kryesore. (Çdo krah ka nga një wc, në katin përdhesë, aty ku fillojnë shkallët për në katin tjetër, gjenden dy dyer anash, që shpiejnë në oborrin e burgut i cili është i ndarë më dysh me një mur 4-5 metra të lartë.

Në fund të oborrit është karakolli, ku qëndron vazhdimisht një polic i armatosur, i cili

njëkohësisht përcjell shëtitjet e të burgosurve për të reaguar në çdo kontakt të mundshëm në mes tyre me të burgosurit tjerë nëpër dhoma. Një anë të oborrit e përbën muri i lartë i ndërtesës së drejtorisë së burgut dhe kuzhinës, mbi të cilin edhe gjendet karakolli. Dy anët tjera kufizohen me muret e burgut. I gjithë oborri është i shtruar në beton. Në dy pjesët e oborrit gjenden nga dy rrathë të vizatuar në cemento, brenda të cilëve duhet të kryhet shëtitja. Shëtitja bëhet në anën e kundërt të kahjes së akrepave të orës. Diametri i rrathëve është 3-4 m. Kur shëtisja i pata matur se staza i ka 27 hapa normal gjegjësisht 13-15 m. Në çdo njërën anë të murit ndarës, përfundi karakollit kishte nga një kthin katror rreth 1-1 metër, ku ishin të vendosur nga një "boiler" me nga një dush. Qelitë ishin në formë jo të rregullt dhe s'ishin të gjitha njësoj por nga madhësia. Ato, pa përjashtim ishin të vogla dhe silleshin prej 2 gjer 2 metra e 20 cm apo edhe gjer në 2 metra e 50 cm. Në katin e parë tavani i dhomës nuk ishte horizontal, por i pjerrtë. Dritaret e qelive ishin të vogla. Pastaj vinin grilat e hekurta dhe pas tyre vinin edhe kornizat e pjerrta me qelq të trashë me tela, largësia e sipërme nga muri i tyre ishte rreth 20 -30 cm. Kurrë nuk kishte ajër të mjaftueshëm. Qelitë ishin të shtruara në dërrasa. Shtretër nuk kishte fare, i jepshin vetëm nga dy dyshekë dhe prapë këmbët mbeteshin në dërrasa. Në qeli kishte edhe një çyp të plastikës, që quhej "kibëll", për kryerjen e nevojës. Dimër ose verë, të burgosurve u jepnin nga dy "çebe" të vjetra, shumica e të cilave ishin të grisura fare. Nëpër qeli kishte shumë insekte të zeza sa kokrra e grurit, prej të cilave, ku të preknin të bëheshin puçrra. Ndodhte që fytyra dhe duart të bëheshin sikur të na kishin thimthuar bletët. Në qeli isha vetëm gjatë tërë kohës së hetimeve. Edhe pse të burgosurit kishin të drejtë të shëtisin dy here në ditë nga 5-10 minuta, në rrethin e vizatuar në oborr, mua dhe shokët e mi, një kohë e gjatë, gati një muaj e gjysmë nuk na nxorën në shëtitje fare. Merrni me mend, një muaj e gjysmë pa e parë qiellin me, pa thithur kurrë ajër të pastër, vetëm vullneti i çeliktë mund t'i bëjë ballë një presioni të tillë.

Me rendin shtëpiak të burgut kishim të drejtë parapaguanim gazeta dhe revista. Këtë të drejtë na e garantonte edhe ligji, për ne të burgosurit politikë shqiptarë kjo nuk vlente. Për ne, vlente ligji i plotëfuqishëm i UDB-s fashiste jugosllave, i cili na ndalonte edhe të drejtat me elementare të burgosurve. Qëllimi kryesor i tyre ishte që në mungesë të shtypit të përditshëm, ne të shkëputemi nga rrjedha e jetes jashtë burgut dhe të jemi jashtë çdo zhvillimi të ngjarjeve. Pastaj në mungesë të angazhimit të mendjes në qeli ne nuk na mbetej tjetër veçse të mendonim për ato gjëra që i kërkonte UDB; dhe të

mendonim veçanërisht për torturat që na i bënin dhe do të na i bënin akoma. Duke mos gjetur kurrfarë ushqimi shpirtëror as në shtypën që nuk na lejonin e as në librat që nuk na jepnin, ata mendonin se në fund të fundit nga torturat e vazhdueshme në UDB-në dhe nga vetmia totale në qeli ne do të thyheshim.

Në kushte të vështira dhe pa askënd pranë, përsëri do të gjeja mënyrën për të siguruar ndonjë pjesë gazete. Por ç'bëja unë për të lexuar vetëm një rresht gazete? Ishte rrezik të më zinin por nuk qaja kokën për asgjë, vjedhja dhe kur më jipej rasti i lexoja në qeli me ëndje të posaçme. Kur i çonin të burgosurit në larje ata l merrnin gazetatat me vete, sepse kthina ku ishte dushi, ishte e vogël dhe s'kishte vend fare për rrobe. Prandaj dimër e verë të burgosurit e shkretë ishin të detyruar të disheshin dhe të visheshin jashtë kthinë së larjes. Por së paku që rrobat të mos i linin në çimento, ata merrnin gazetatat me vete dhe kur shkonin nëpër qelitë e tyre ato i linin aty gjysmë të lagura e të shkyera. Kjo një njeriut si unë s'i pengonte aspak. Prandaj, kur më qitnin t'i shkund batanijet të dielave, e sidomos kur kishte edhe larje, bëja çmos për të futur ndonjë copë gazete në palë të "çebeve". Duke i shkundur batanijet e vështroja gardianin në karakoll dhe posa i largonte një moment sytë nga unë, menjëherë me të shpejtë grabisja ndonjë gazetë dhe e fusja në batanije. Një herë një gardian më kishte parë dhe duke bërëtitur më urdhëroi të nxirja gazetën nga batanijet, por prapë se prapë një pjesë e mora me vete. Një herë kur më rroi berberi, duke dalur nga zyra shfrytëzova rastin kur gardiani ishte në korridor dhe i kërkova berberit një gazetë të vjetër, por mundësisht të pastër që ta shtroja kur të haja bukë.

Duke mos kuptuar qëllimin kryesor ai më dha një tubë gazetash në gjuhën serbishte, kjo s'prishte aspak punë, dhe duke dalur me mjeshtri i futa nën xhemper dhe me gardianin prapa shkova në qelinë time. Këto raste i kisha gëzimet më të mëdha gjatë hetimeve, kur nuk kisha as shetitje, as vizita, as literaturë dhe as ndonjë shok pranë që të bisedoja. Nuk më linin fare libra, edhe pse në rendin shtëpiak të burgut dhe me ligj kisha të drejtë për dy libra në javë. "Jo, më thoshin hetuesit, kur ua kërkova ngulmërisht, duhet të mendosh më shumë për këto që po të pyesim dhe po t'i kërkojmë do të japim gazeta e libra sa të duash, bile do të sjellim në qeli edhe ndonjë femër të bukur të flasësh me të...por me kusht që të bindesh dhe të tregosh sinqerisht për ato që po t'i kërkojmë.

Pa shëtitje dhe pa literaturë e gazeta, pa asnjë njeri në qeli për të këmbyer një fjalë dhe nën presionin e përhershëm të torturave më shtazarake ishte bukur e vështirë të përballojë njeriu, por të merremi vesh, nuk ishte punë që s'bëhet, sepse njeriu i fortë me besimin e patundur në idealin e tij i përballon të gjitha.

Pas një muaj hetimesh e torturimesh, kur ndodhesha në kthinën e rojtarit (ishte rojtar civil), i thashë të më shkurtojë flokët sepse i kam të yndyrshme dhe prej zbokthit po më kruhet koka... pasi filloi të më nënqethë, më pyeti: a t'i heqi krejt? Gati sa nuk kërceva nga gëzimi. Po, i thashë i gëzuar sa s'ka më, edhe më mirë bile. Policët tani më nuk do të mund të më kapnin për flokësh për të ma përplasur kokën për muri, edhe pse këtë, ata mund ta bënin edhe ndryshe. Por kryesorja ishte se për flokësh nuk do të mund të më tërhiqnin më, sepse kur më kapnin për flokësh, të shumtën e rasteve edhe m'i shkulnin fare. Bile kur më tërhiqnin me tërë forcën, thosha se ma shkulën tepen e kresë. Kur më panë në UDB pa flokë, u tërbuan sa s'bëhet. Menjëherë kërkuan sqarime nga drejtorja e burgut, por tani ishte vonë.

“

Ishin çaste që nuk mund të përshkruhen. Fjalët e shokut pas kaq kohësh. Inkurajim më të madh në këto çaste as s'mund të paramendohet. Ditët që pasuan shkonin në pritje të shëtitjes, në pritje të përshëndetjes me shokun tim Hekuranin. Prej tij mësova për një shok tjetër se në cilën qeli ndodhej. Në keto biseda të shkurtëra ndërinformoheshim për torturat që na bënin dhe për qëndresën e njëri-tjetrit.

”

SHETIJA E PARË NË AJËR TË PASTËR DHE 'TAKIMI' ME HEKURANIN

Pas gati një muaj e gjysmë më nxorën për herë të parë në shëtitje. Ishte ditë e mire me diell. Bora zbardhëllonte në çdo anë. Përnjëherësh i mbylla sytë, sepse nuk isha në gjendje t'i hapja. Kishte kohë që s'kisha parë dritë e diell me sy, as borë të bardhë, shkëlqimi i së cilës m'i verboi sytë fare. Por dalëngadalë u mësova disi, edhe pse sytë më digjnin nga drita. Duke u shetitur e kapa një grusht borë dhe e shtrëngova në duar. Pastaj e mora pak borë të pastër dhe fillova ta ha me ëndje. Por gardiani nga karakolli më thirri dhe më tha me ngërmim të shëtis e të mos luaj me borë. Të poshtrit, as me borë s'më lënë të luaj! Tani e tutje do të më nxirrnin në ajër të pastër nga dy herë në ditë nga 5-10 minuta... E ç'janë 10 ose 20 minuta në ajër të pastër për 24 ore? Po unë edhe me kaq kënaqesha, sepse e shihja diellin. Nga të katër anët mure të larta, të pakapërcyeshme. Karakolli. Gardiani. Mbi të gjitha qëndronte ndërtesa e UDB-së, prej ku medoemos vëzhgonte dikush. Në rrethin ku shëtitja në anën e majtë kishte edhe 5 dritare të qelive të katit përdhesë. Që ditën e dytë nisa të thërras me zë të ulët emrat e shokëve, për të cilët e dija se gjindeshin në këtë burg. Në dy dritaret e para m'u përgjigjën se nuk kishte të burgosur me emra të tillë, në qelitë e tyre. Kuptohet tërë këtë e bënim me zë të ulët dhe me kujdes shumë të madh; kur vëreja se gardiani nuk më shikonte, vëja dorën në gojë gjoja për të kollur... Pas tri-katër ditësh shëtitje dëgjova të thërras dikush nga dritarja e pestë "O Skifter! A je ti? Tere trupi m'u rrënoqeth. 'Jo, nuk jam u përgjigja me zë të ulët. Prapë zëri nga qelia: Kush je ti?" Unë iu përgjegja: "Jam Kushtrim Guri, përgjigje nuk mora menjëherë. Kujtova se nuk lajmërohet më, kur papritmas dëgjoj: "Këtu është

Hekurani". Kjo më erdhi sikur të më thoshte: "Ku është Hekurani? Prandaj iu përgjegja se me sa di ai është në burgun e Pejës, Kur nga dritarja dëgjova sërish: "Këtu është Hekurani!". Por tamam atëherë më thirri gardiani. Shëtitja e paraditës kishte mbaruar.

Tërë ditën gjer kah 15 e 30, kur përafërsisht më nxirrnin në shëtitje, bredhja nëpër dhomë. Me padurim e prisja shëtitjen e pasdrekes. Erdhi edhe koha e shëtitjes. Kësaj radhe i mora edhe cigaret me vete, sepse mund të më shërbenin mrekulli në rast se do të bisedoj sërish. Posa dola në hapin e pare u kollita dy herë. Menjëherë u dëgjua e kollitura në dritaren e fundit si përgjigje. Sapo bëra dy xhiro u kollita edhe një herë. Nga dritarja erdhi nje e kollitur. "A je Kushtrimi?" më pyeti. Po, iu përgjegja: "Unë jam Hekurani" më erdhi zëri nga qelia, më dukej se zëri i vinte nga nëntoka, nga ndonjë l vdekur.

Nga torturat e përpjekjet që të flasë me zë sa më të ulët nuk mund t'ia dalloj zërin se ishte i tij. E pyeta: Si je, a je mire? Ai m'u përgjigj: "Mirë, mirë jam! Mos u mërzit!" Ç'ma mori fjalën nga goja! Unë doja ta porosisë që të mos mërzitet dhe se duhet të qëndrojmë gjer në fund, por ai më tha përpara. Kur shëtisja, i afrohesha afër dritares dhe mundja të bëja ndonjë pyetje, por edhe të dëgjoja përgjigjen e tij. Një xhiro, një fiali. Kuptohet se këto bëheshin vetëm kur nuk shikonte gardiani. Njëherë flisja unë, në xhiron tjetër fliste ai. I përgjigjem: "Ma Çfarë mërzie, more! Kush të mërzitet?" Në xhiron tjetër do të vazhdoja: "S'mërzitemi!" Këto ishin fjalët e fundit kësaj radhe, sepse shëtitja u krye. Si të përshëndetur lëshova një të kollitur, në se shenjë se po më qojnë në qeli. E kollitura e Hekuranit pasoi menjëherë.

Ishin çaste që nuk mund të përshkruhen. Fjalët e shokut pas kaq kohësh. Inkurajim më të madh në këto çaste as s'mund të paramendohet. Ditët që pasuan shkonin në pritje të shëtitjes, në pritje të përshëndetjes me shokun tim Hekuranin. Prej tij mësova për një shok tjetër se në cilën qeli ndodhej. Në keto biseda të shkurtëra ndërinformoheshim për torturat që na bënin dhe për qëndresën e njëri-tjetrit.

A është ndier ndonjëherë më parë që në burgun famëkeq të Prishtinës të torturuar çdo ditë pa asnjë faj, të mos lëshojmë të na kalojë shëtitje pa i dërguar njëritjetrit përshëndetje dhe parulla? Unë vetëm në libra kisha lexuar gjëra të tilla. Kur iu afrojsa

dritares e ngrisja dorën me cigare dhe gjoja po e thith duhanin mbyllia gojën dhe ia bëja të pamundur gardianit në karakullë, policit në dritare të UDB-së dhe gardianit tjetër në zyrën e tij në kat, të më shihnin kur thërrisja “Rroftë populli shqiptar” Përgjigja: “Rroftë”. Pasonin kështu shëtitjet e përditshme dhe parullat bëheshin të rregullta si një qendresë ndaj torturave që bëheshin në UDB. Do të thërrisnim parulla të shumta si: Poshtë revizionistët jugosllavë! "Poshtë borgezia!" "Vdekje fashizmit-Liri popullit", "Coftë kali i Trojës!" "Fitorja është jona" e shumë të tjera. Këto parulla na u bënë ushqimi më i mire që mund të dëshironim në ato çaste. Duke rrezikuar sa s'bëhet ne do të këmbenim edhe letra në të cilat shkruanim më gjerësisht për gjërat që na kerkonin në UDB. Dhe për qëndrimin që duhej mbajtur para hetuesve dhe gjyqit. Edhe pse rreptësisht ndaloheshin lapsat, ne gjenim mënyrën që të vijmë gjer te ta.

Kur isha në qeli, s'kishte ditë të mos këndoja e fishkëlloja. Kjo ishte rreptësisht e ndaluar, por a mund të ndalte dikush zemrën që po këndonte? Jo, këtë s'mund ta bënin, siç s'mundja ta bëj as unë vetë. Posa më dëgjonin që po këndoj, vinin, e hapnin derën me tërsëllimëm dhe më kërcënoheshin...Por posa dilnin dhe dëgjoja se u larguan, ia filloja sërish këngës. Në fillim ia nisja me zë të ulët, po kur më përfshinte entuziasmi, duke qenë plot vullnet dhe optimist, e lëshoja zërin aq sa gardianët kishin mundësi të dëgjonin shkoqur këngën time. Pastaj vinte natyrisht, intervenimi i gardianëve, qjerrjet e tyre dhe kërcënimet, e nuk mungonin as ndëshkimet. Por si të mos e lëshoja zërin kur e këndoja "Xhamadanin e trimërisë"? Nga vargjet e kësaj kënge, sig janë: "S'ka q'ka i ban topi Sulltanit.../ Zemra jonë ka gjak sa gurra, / Mbi armikun bini burra! Pastaj: Sytë me dritë na i mbush Shqipnia!" dhe në fund: "Të gjithë shqiptarët janë Mic Sokola!" Edhe i vdekuri do të klithte thirrje luftarake, e jo më unë që isha plot optimizëm e vullnet të pathyeshëm. Po kujt i këndoja? I këndoja popullit tim, heronjve të tij legjendarë, u këndoja dëshmorëve të rënë për liri, i këndoja qëndresës dhe mospërkuljes shekullore të popullit tim.

“

Ushqimi shumë i dobët, ndalimi edhe i këngës në qeli, larja shumë e rrallë dhe si mos më keq, gjërat shumë të kufizuara për blerje në burg; moslejimi i kontrollimit të domosdoshëm mjekësor; mosdërgimi i letrave familjes..., të gjitha këto bëheshin për të vetmin qëllim të na shkatërronin moralisht e fizikisht, të na thyenin, të na nënshtronin, të na demoralizonin dhe të na detyronin më në fund, të bashkëpunojmë me UDB-në famëkeqe.

”

VIZITA E PARË...

Të gjithë të burgosurit kishin të drejtë nga 10-15minuta vizitë, njëherë në dy javë. Por unë dhe shokët e burgosur jo. Neve nuk na lejonin të na vizitonte askush. Na i lejonin vetëm rrobat dhe ca gjëra Dhe ato mjaft të kufizuara. Gjysmën e gjërave na i kthenin prapa. Rrobat i kontrollonin mirë e na i jepnin. Ndërsa gjërat ushqimore i prenin e i copëtonin aq shumë sa nuk mund t'ua dinte njeriu as formën që kishin pasur. Çdo gjë prekej e çilej, prekej nga duart e policëve, të cilat sigurisht se nuk ishin të pastra. Gjërat tona ishte rreptësisht e ndaluar të na dorëzohen pa kontrolluar njëherë e mirë në UDB. Shpesh më shkante mendja se mund të qitnin diçka në ushqim, gjërat që i ktheja për t'i larë, kontrolloheshin sa s'bëhet; së pari i kontrollonin mos kishte ndonjë gjurmë gjaku pa fshirë, e pastaj mos kishte ndonjë letër apo diç tjetër të fshehur në rroba. Pas disa muajsh nga presioni dhe këmbëngulja e familjes për të më parë, më në fund ma lejuan vizitën. Kur më thirrën nuk e dija se ku më qonin. Për vizitën më njoftuan vetëm kur më futën në vendin për takime me anëtarët e familjes. Ky vend ishte me një rrjetë të hekurt e të lartë gjer në tavan. e aq i lartë mbi toke nuk lejonte t'i afroresh rrjetit metalik, një hekur i ngjashëm ishte edhe në anën tjetër.

Aty ishin disa udbashë dhe gardianë. Një udbash dhe dy gardianë me rrinin anash që të kenë mundësi të shihnin sa më mirë se çka do të flasin dhe si do të sillen ata që më kishin ardhur në vizitë. Ndërsa policët dhe gardianët tjerë rrinin anash apo pas dy anëtarëve të familjes që me kishin ardhur në vizite. Nena posa më pa u zgjat mbi hekurin dhe i futi gishtërinjtë në rrjetin që së paku t'i prekë gishtërinjtë e mi. Por nuk mundja ta zgjas dorën, jo pse frikohesha, por pse nuk doja nëna të m'i shohë duart e mia të enjtura e të bëra çivit

nga torturat. Shpejt e shpejt i vura duart në hekurin para vetes, gjoja të them se është e ndaluar. U përshëndetëm kështu përmes rrjetit, i pyeta si janë të shtëpisë dhe pa u bërë një minut e gjysmë na urdhëruan të përshëndetemi, se vizita ishte kryer. Nuk arrita as t'i shoh mirë dhe as t'i pyes për të gjithë njerëzit e shtëpisë. Megjithatë ishte i sigurt se te mitë nuk i ka befasuar kjo egërsi fashiste, sepse ata qysh herët e kanë mësuar dhe e kanë përjetuar në kurrizin e tyre urrejtjen shoviniste të serbomëdhenjve.

Pas një kohe, kur veç kishin kaluar disa muaj hetime, me këmbënguljen time u detyruan të m'i lejojnë shtypin dhe literaturën. Me rendin shtëpiak çdo i burgosur kishte të drejtë t'i dërgojë në shtëpi dy letra në muaj dhe të merrte po aq. Por letrat e mia nuk i lëshonin. Vetëm me kusht që në to të shkruaj thatë e thjeshte për gjërat më të rëndomta familjare. Përndryshe letrat që kam shkruar për trajtimin në UDB dhe në burg, apo për ndonjë çështje tjetër lidhur me to, jo vetëm nuk m'i kanë dërguar, por as që m'i kanë kthyer ndonjëherë. Na e ndalonin rreptësisht që të shkruanim për jetën në burg dhe çdo gjë rreth saj. Edhe në vizitë me familjen vlente ky rregull. Mjaftonte vetëm të çilej goja për çështje të hetimeve e torturave dhe vizita ndërpritej menjëherë. Mirëpo edhe ato letra të miat, në të cilat nuk gjenin asgjë të dyshimt, megjithatë i vononin shumë sikundër që i vononin letrat që m'i dërgonte familja.

Pra, krahas torturave të përditshme fizike që na i benin në UDB, na benin në çdo rast edhe presione e tortura psikike nëpërmjet personelit të burgut. Në UDB më torturonin duke me rënë duarve me kërbac, shputave të këmbëve, në shpinë, thjeshtë në tërë trupin. Më binin me grusht fytyrës, më binin përnjëherë me të dy duart në vesh, më binin grushte e me shqelma kudo që mundnin. Më kapnin për organe gjenitale dhe m'i shtrëngonin. Më kapnin për flokësh e ma përplasnin koken për muri. Më detyronin të qëndroja tërë natën në këmbë, me kërcënonin, me shanin, me pështyenin, më fyenin e më poshtronin.

Ndërsa përmes drejtorisë së burgut bënin presione të shumta psikike. M'i ndërronin gati në çdo muaj qelitë, sa më çonin në qeli të shtruar në dërrasa dhe me dritare, sa më çonin në qeli me çimento dhe në vend të dritares një llamarinë e shpuar. Pastaj më çonin në qeli të shtruar me beton, por me dritare. Përsëri më nëvoje për tjetër mjek, përderisa ata kishin mjekun e burgut për ne, e mbi të gjitha se unë isha i shëndoshë, e nëse doja mjek

tjetër duhej te prisja gjersa të dilja nga burgu.

Larja me rend shtëpiak bëhej dy here në muaj, por mua dhe shokët e mi nuk na dërguan të laheshim fare dy muaj. Pastaj vetem një herë në muaj. Një muaj rresht na mblidhej zdrali në trup, ndërsa kur shkonim të laheshim, na ndërprenin: gardiani rrinte te dera dhe nuk arrinim asnjëherë t'i biem trupit me sapun, kur gardiani thërriste si i qmendur të dilnim, sepse "larja mbaroi"! Kur i thosha se akoma nuk isha lagur mirë e lëre të isha larë, ai nxirte "pendrekun" dhe me te shara e me te bërtitura më detyronte të dalë nga uji, edhe pse i pa larë.

Njëherë në muaj mund të blenim diç përmes burgut. Por lista e artikujve ishte shumë e shkurtër dhe kryesisht kishte të bëjë me gjëra të higjienës personale, cigare dhe ndonjë kuti biskotash. Keto ishin më se të pamjaftueshme, kur dihej se çfarë ushqimi të pamjaftueshëm na jepnin. Pastaj kjo blerje shpesh nuk vinte fare.

Të gjitha këto: torturat e përditshme më çnjerëzore psikike dhe fizike në UDB, lënia në vetmi në qeli të mykura dhe pa ajër gjatë tërë kohës së hetimeve, herë në qeli të shtruar me dërrasa e herë në ato në cemento; dyshekë e batani të vjetra e të grisura, pa të drejtë përdorimi që ditën të shtrihesh në to, pa të drejtë përdorimi të "çebeve" gjatë ditës, gati një muaj e gjysmë pa shetitje në ajër të pastër; disa muaj pa vizita, disa muaj pa shtyp e literaturë, pa laps e letër në qeli, më dërgonin në çeli të shtruara me dërrasa dhe dritare . Kështu më shëtitnin gjatë tërë kohës së hetimeve, gjer pas gjykimit. Nuk më lejonin vizitën, nuk më lejonin të lexoj, nuk m'i lëshonin letrat e familjes, nuk më lejonin as të këndoja!

Ushqimi në burg ishte shumë i dobët. Sa për të mbajtur frymën gjallë. Çdo ditë kishte ushqim të njëjtë: ujë të zi kafeje pa sheqer çdo darkë kishim makarona pa yndyrë, për drekë katër herë në javë kishim pasul e dy herë patate. Mish kishte njëherë në javë, të hënën, kur kishte edhe pasul. Por duhej të kishe fat nëse të binte ndonjë copë e vogël mishi, nëse rastiste në lugën e madhe, me të cilën na e qitnin pasulin. Çdo ditë në drekë n takonte nga gjysmë buke të cilën duhej ngrënë për 24 orë. Vetëm me ushqim të tillë, pa ndihmë nga shtëpia, edhe organizmi më i fortë do të dobësohej dhe vështirë që do të mbetej gjallë kur çdo ditë na torturonin e masakronin në UDB.

Ngaqë isha i sëmurë nga torturat, kërkoja të më kontrolloj mjeku. Por më kqyrte vetëm mjeku i burgut, të cilin të burgosurit me të drejtë e quanin veterinar. Për të të gjithë të burgosurit ishin të shëndoshë, e sidomos ne të burgosurit politikshqiptarë, e që torturoheshim me muaj të tërë, nga disa herë në ditë.

Me mundime të mëdha ecja, sepse shputat i kisha të shtypura e të dërrmuara nga torturimet e përditshme. Kur u kërkoja të më sillnin nga jashtë mjekun, me shpenzimet e mia, tërboheshin fare. Më thoshin se nuk ke kurrfarë sëmundje.

Ushqimi shumë i dobët, ndalimi edhe i këngës në qeli, larja shumë e rrallë dhe si mos më keq, gjërat shumë të kufizuara për blerje në burg; moslejimi i kontrollimit të domosdoshëm mjekësor; mosdërgimi i letrave familjes..., të gjitha këto bëheshin për të vetmin qëllim të na shkatërrojnë moralisht e fizikisht, të na thyenin, të na nënshtonin, të na demoralizonin dhe të na detyronin më në fund, të bashkëpunojmë me UDB-në famëkeqe.

“

Në Kushtetutën e Jugosllavisë gjithashtu figuron se është e ndaluar dhe e denueshme me ligj çdo torturë fizike, çdo diskriminim dhe çdo denigrim i personalitetit të qytetarëve. Por të gjitha këto janë vetëm shkronja të vdekura në letrat e pluhrosura.

”

“

Lëvizja në Kosovë ka herë kishte lëshuar rrënjë mbi baza të shëndosha ideopolitike dhe kishte fituar besimin e plotë të popullit tonë. Prandaj me të drejtë quhet e vetmja përfaqësuese e ligjshme e popullit shqiptar në Jugosllavi. Lëvizja kishte depërtuar në të gjitha shtresat e popullsisë dhe organizativisht kishte arritur nivel të lartë.

”

NGRITJA E AKTAKUZËS PA ASNJË FAKT DHE DËNIMI

Pas 6-7 muajsh ma ngritën aktakuzën mua dhe shokëve pa asnjë mbështetje në fakte materiale. Aktakuzë që mbështetej kokë e këmbë në thashethëna dhe në deklarata të njerëzve të torturuar dhe të shantazhuar. Kjo është gjë e rëndomtë për UDB-në fashiste. Jugosllavia është nënshkruese e shumë akteve e konventave ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut që ndalojnë dhe dënojnë torturat dhe diskriminimin kombëtar e racial.

Në Kushtetutën e Jugosllavisë gjithashtu figuron se është e ndaluar dhe e denueshme me ligj çdo torturë fizike, çdo diskriminim dhe çdo denigrim i personalitetit të qytetarëve. Por të gjitha këto janë vetëm shkronja të vdekura në letrat e pluhrosura.

Për një regjim antipopullor antidemokratik, për një regjim kolonialist' siç është regjimi jugosllav, këto janë vetëm farsa vetëm një pudër e tejdukshme, ky regjim terrorist ua kalon edhe regjimeve më të egra të Mesjetës' ua kalon edhe regjimeve më antipopullore të Kilit' Salavadorit, Afrikës së Jugut, ia kalon edhe regjimit sionist të Izraelit.

Regjimi serbomadh është edhe shumë më përfid se këto që përmendëm, sepse ai ndaj popullit tonë përdorë metoda shumë të fshehta e dhelprake të shfarosjes e asimilimit. Gjersa para Pranverës së lavdishmë të vitit 1981, pranverë që do të shënohet me shkronja të arta në historinë e popullit shqiptar, regjimi fashist jugosllav përdori mënyra e

metoda të kamofluara terroriste, tani u detyrua ta tregojë para botës fytyrën e tij të vërtetë, fytyrën e një regjimi të kalbur e të egër.

Aktakuza le që ishte shkruar në bazë të deklaratave të dhëna nga persona të shantazhuar e të torturuar, pa kurrëfarë faktesh materiale, por edhe ishin shtuar gjërat e ishin rregulluar tamam sipas regjisë satanike të UDBsë. Si të burgosurit tjerë, ashtu edhe unë, kundërshtuam dhe kërkuam që aktakuza të rishikohet e revidohet. Por, këto gjëra bëheshin vetëm me vullnetin e UDB-së, andaj edhe kërkesat tona për revidim të aktakuzës u refuzuan si të pa baza.

Me ligjet jugosllave i burgosuri ka të drejtë të mos përgjigjet në pyetjet e hetuesve pa prezencën e mbrojtësit (avokatit). Çfarë ironie ndaj ligjit që në rrethanat dhe kushtet e Kosovës nuk respektohet kurrë. Me ligj është përcaktuar se i burgosuri, që s'ka mundësi materiale për të paguar mbrojtësin, këtë është i obliguar ta bëjë gjyqi! Edhe pse mbrojtësi duhet të caktohet me kohë dhe të jetë në rrjedhë të hetimeve, ata ma caktuan vetëm disa ditë para ditës së gjykimit për të biseduar në lidhje me atë që më ngarkonte aktakuza. E prita më kot sepse ai nuk erdhi fare. C'është edhe më e quditshme, ai nuk kishte shfletuar fare aktakuzën time. Këtë ma tregoi që të prezentohet, por më pati thënë se do të interesohet te gjykatësi nëse do t'ia mundësonte ta lexojë aktakuzën. Çfarë poshtërsie, "mbrojtësi" të mos e dinte se çka përmban aktakuza, gjër ditën e gjykimit!

Edhe perkundër gjithë këtyre torturavë e karaxhozllëqeve, është interesant se të gjithë në UDB ishin plotësisht të bindur se nuk ishim fajtorë, as aktorë të veprave për të cilat akuzoheshim. Sipas praktikës së UDB-së dikush duhej dënuar.

Jam duke jetuar në kohën kur bëhen ndërrime të mëdha revolucionare. Andaj shprehja "po nuk u more ti me politikë, politika do te merret me ty", është shprehje shumë me vend, dhe shpejt a vone këtë do ta vërtetojë secili. Kjo shprehje, moto e ditëve tona, nuk di a është shkruar dikund, unë për vete e kam dëgjuar nga një shok imi, poashtu i burgosur politik shqiptar, vërtetësinë e saj e dëshmoi në revolucionin e vitit 1981 në Kosovë.

Erdhi edhe dita e gjykimit, salla ishte e mbushur me vetëm nga një anëtar nga familjet e të burgurve dhe plot policë e gardianë. Neve një nga një, të lidhur me pranga, na sollën

në sallën e gjyqit. Çdonjërin na ruanin nga dy policë. Kur hyra në sallë të gjithë kthyen kokën. S'kam çka të fsheh, isha shumë i gëzuar. Nuk ishte punë e vogël të torturohesh e të trajtohesh në mënyrën më barbare për muaj me radhë e të dalësh në gjyq faqebardhë, pa tradhtuar askënd, bile duke marrë mbi vete gjëra që as nuk ishin të miat. Posa e pashë anëtarin e familjes sime u ktheva nga ai dhe e përshëndeta ani se ishte e ndaluar. Ashtu duarlidhur u përqafova edhe me shokët, duke shkaktuar kështu shqetësimin dhe tërbimin e gardianëve dhe udbashëve, të cilët i nxorën kërbaçet për të na ndarë nga përqaqimi.

Lëvizja në Kosovë kaherë kishte lëshuar rrënjë mbi baza të shëndosha ideopolitike dhe kishte fituar besimin e plotë të popullit tonë. Prandaj me të drejtë quhet e vetmja përfaqësuese e ligjshme e popullit shqiptar në Jugosllavi. Lëvizja kishte depërtuar në të gjitha shtresat e popullsisë dhe organizativisht kishte arritur nivel të lartë.

Policët na kërcënonin që të mos kthehemi nga njëri-tjetri dhe të mos komunikojmë fare mes veti dhe me anëtarët e familjeve që ishin prezentë. Milicë, gardianë e udbashë na qëndronin mbi kokë, gjersa edhe gjykatësi, prokurori dhe porotët, këta shërbëtorë të bindur të regjimit nuk hynin e nuk zinin vend. Pastaj na lejuan edhe neve të ulemi. Na thirri gjykatësi një nga një të qëndrojmë brenda në gjysmërrethin e lartë rreth 1 metër e 20 cm.

Na pyeste për emrat e mbiemrat, për emrat e prindërve e të familjes, jemi të punësuar apo jo, kemi kryer ushtrinë, etj. Pas kësaj procedure na thërrisnin të qëndrojmë në këmbë, ndërsa prokurori lexonte aktakuzën. Pas edhe kësaj procedure të gjithë, të burgosurit i larguan nga salla, duke lënë aty për pyetje vetëm të akuzuarin e parë. Gjykatësi e merrte në pyetje, çdonjërin, lidhur me atë që akuzohej; dhe puna kryhej shpejt pasi që gjykatësi fashist nuk lejonte të flitej asgjë veç asaj që e pyeste. Pastaj të njëjtën gjë e bënte me çdo të akuzuar.

Ishin këto gjëra formale sa për t'i hedhur popullit hi syve, sepse dënimet ishin përcaktuar më parë nga instancat më të larta politiko-policore të shtetit. Ne na kishin caktuar të na dënojnë me vite të tëra me burg pa marrë parasysh rrjedhën e gjykimit.

Torturat e shumta dhe presionet e ushtruara mbi ne justifikoheshin si të domosdoshme Për të "nxjerrë të vërtetën". Por, kur ishte që ato të thuheshin në gjyq dhe të qiteshin në

shesh, atëherë gjykatësi na ndërprente brutalisht: "Kjo s'më intereson. Kjo është çështje e organeve hetuese." Ne i thoshim: "Si nuk ju intereson, kur neve na kanë shkatërruar dru? Kur një gjë e tillë është e ndalueshme dhe e dënueshme me ligj?" Por gjykatësi na e prente shkurt: "Fol nëse ke çka të flasësh për këto që akuzohesh, e për ato të tjerat s'dua të dëgjoj fare! Nëse s' ke çfarë të flasësh, ulu!"

Shihej se atij nuk i interesonte se si zhvillohej procedura fare, gjersa përfundimin e gjykimit e kishte të përgatitur e edhe dënimet i kishte të shkruara që para procesit, në plikon e UDB-së. Pastaj defilonin njëri pas tjetrit dëshmitarë të njohur e të panjohur. Deklaratat e tyre dhënë gjatë hetuesisë edhe sot mbetën të panjohura për ne, sepse në gjykim ata pyeteshin për gjëra të tjera, shumë prej të cilave nuk kishin kurrfarë lidhjeje me aktakuzën dhe gjykimin. Thua jse ishte një shou program që e udhëhiqte gjykatësi i dirigjuar nga UDB.

Kishte dëshmitarë që refuzonin të vërtetojnë deklaratat që i kishin në UDB nën presion e tortura, duke thënë se kanë qenë të shtrënguar të bëhen dëshmitarë. Kishte dëshmitarë që thoshin se të akuzuarit nuk i njihte fare e as që i kishte parë ndonjëherë, por gjoja kishte dëgjuar Për punën e tyre nga një person tjetër. Por kur pyetej se nga kush kishte dëgjuar, atëherë ishte i shtrënguar të pranojë hapur se deponimet e tij ishin të rrejshme, se ishin dhënë nën presionin dhe shantazhin e UDB-së.

Kur donim të pyesnim ndonjërin për diç që gjykatësit i prishte punë menjëherë na refuzonte dhe na detyronte të ulemi. Edhe perkundër kësaj farse me gjykatësin në krye, ne të akuzuarit ishim të disponuar dhe bile qeshnim. Kur na tërhiqej vërejtja të mos qeshim ne u thoshim: "Pse të mos qeshemi? Paj, ne sot kemi dasmë!" Gjykatësi, prokurori dhe porotët tërboheshin fare. Tërboheshin se e dinin si një e një që bëjnë dy, se ne nuk ishim aspak fajtorë për gjithë ato që na ngarkonin, ndërsa ne prapë se prapë ishim të disponuar, dhe as qanim kokën për ato që llogotisnin prokurori e gjykatësi edhe pse ishin ne pyetje vite të tëra burgimi. Disa herë gjykatësi më kërcënoi të mos qeshi se do të më nxirrte jashtë dhe procesin gjyqësor do ta vazhdonte ne mungesën time. Gjykatësit në Kosovë, në këso rastesh bëhen fare qesharak.

Prej të gjithë atyre dëshmitarëve, që ishin mbi njëzet, nuk doli një apo dy që qëndruan pranë deklaratave të dhëna në UDB. Pas dëshmitarëve fjalën e moren mbrojtësit, kush

kishte paguar mbrojtës edhe mbrohej më mirë; ndërsa avokatët tanë që na i kishte caktuar gjyqi, ishin krejtësisht qesharak. Lëre më që nuk hynin në thelbin e çështjes, por pa fije turpi e aprovonin aktakuzën dhe për ne kërkonin dënime, por "mundësisht sa më butë"! Sepse gjoja ishim te rinj! Pas tyre na e dhanë fjalën (e fundit) edhe neve.

Vetëm njëri u "pendua" gjoja për veprën e kryer, vepër të cilën nuk e kishte kryer fare, por shpresonte në dënimin më të vogël. Por të gjithë të tjerët mbajtën qëndrim të mirë e të vendosur, edhe pse ishin të vetëdijsëm se nuk ishin fajtorë e as aktorë të veprave që na ngarkoheshin le që nuk pendohej askush, por shprehnin hapur keqardhjen që nuk i kishin kryer aksionet politike për të cilat na akuzonin.

Më kishte mbetur thellë në kujtesë qëndrimi i një të burgosuri politik në një gjykim para Luftës së Dytë Botërore në Tiranë (protagonisti në një roman që kisha lexuar), ku gjykoheshin dhjetëra komunistë; në mesin e tyre ishte edhe një i ri i quajtur Qemal Orhanaj. Në krye të këtyre komunistëve ishte revolucionari i lavdishëm Qemal Stafa. Duke parë qëndresën dhe vendosmërinë e Qemalit me shokë, si gjatë hetimeve, ashtu edhe në gjykim, edhe Qemal Orhanaj mori qëndrim të drejtë si luftëtarë i vërtetë, edhe pse ishte i burgosur pa faj. I inspiruar sa s'bëhet nga ky personazh edhe unë mora qëndrim të njëjtë. Shpreha hapur mendimin para gjyqit, siç kisha shprehur edhe në polici para torturuesve mizorë. Fola për padrejtësitë që i janë bërë Kosovës, duke e shkëputur me dhunë nga trugu amë, Shqipëria, folë për gjendjen e vështirë dhe të pabarabartë të shqiptarëve në Jugosllavi, për politikën shfarosëse e kolonialiste të Jugosllavisë ndaj Kosovës dhe viseve të tjera të banuara me shqiptarë. Në fund u thashë as e ndiej veten fajtor as nuk po pendojem fare për botëkuptimet e mia politike.

Pas dy-tri ditësh, gjykimi mori fund me epilogun e njohur që më parë. Ne, u shpallëm fajtorë për vepra politike kundër regjimit fashist e terrorist jugosllav. Si të tillë edhe u dënuam me dënime të larta, me nga shumë vjet burgim për vepra të tilla, për të cilat na akuzonin neve, në tokat e pushtuara arabe nga Izraeli, në Kili, në Salvador, në Guatemalë, në Kolumbi, në Afrikën e Jugut, etj., do të dënoheshim vetëm me disa muaj burg. Ndërsa në vendet demokratike-borgjeze të Evropës nuk do ti merrte kush në pyetje. Këtu edhe tregohej fytyra e vërtetë e regjimit të kalbur revizionisto-kapitalist e terrorist jugosllav. Menjëherë pas shqiptimit të dënimeve u përqaftuam me shokët. Policët

na i vunë prangat menjëherë dhe na nisën në burg. Duke dalur nga salla e gjyqit ne ngritëm grushtet dhe thirrëm: Mirupafshim në liri! Ishin këto fjalë qëndrese e papërkuljeje. Edhe me pranga në duar i kundërviheshim këtij regjimi të egër antipopullor, këtij pushtuesi fashizoid që si prostitutë pispillosë veten me mijëra pudra.

“

Duke dalur nga salla e gjyqit ne ngritëm grushtet dhe thirrëm:
Mirupafshim në liri! Ishin këto fjalë qëndrese e papërkuljeje.
Edhe me pranga në duar i kundërviheshim këtij regjimi të egër
antipopullor, këtij pushtuesi fashizoid që si prostitutë pispillosë
veten me mijëra pudra.

”

PËRSËRI NË QELI ME PRANGA NË DUAR

Kaloi edhe një kohë pas gjykimit, dhe na linin prapë të izoluar nëpër qelitë e burgut famëkeq të Prishtinës. Në ndërkohë UDB punonte për sigurimin e personave të burgosur e të besuar për të na i sjellur në qeli. Të burgosurit për krime, hajdutëri e dhunime, që për interesin e tyre personal ishin në gjendje të bënin çmos dhe të spiunonin këdo dhe për çdo gjë. Pas kaq muajsh vetmie totale, tani na i sollën të burgosurit spiunë nëpër qeli. Ishin këta njerëz kriminelë të të gjitha ngjyrave. Me një fialë gjithë fundrrinat e shoqërisë së degjeneruar e të kalbur jugosllave. Qelitë ishin të vogla, ndërsa në to na vendosnin nga tre-katër të burgosur, por kur mbushej burgu edhe nga dy herë aq. Njëri po të thithte duhan mjaftonte të të zihej fryma, e lëre më që çdo i burgosur ishte duhanxhi.

Ditën rrija ulur dhe me këmbët e mbledhura, ndërsa natën duhej të radhiteshim sikur peshqit në konservë. Mjaftonte që njëri të lëvizte pak për të na e prishur gjumin të gjithëve. Katër-pesë veta kryenin nevojën në një qyp të vogël plastike, ndërsa qelia ishte e vogël, kështu që kur qelej qypi, e tëra kundërmonte nevojto. Kur ishte nxhetë, sidomos verës, era e qypit të mbyste fare.

Kur na çonin të laheshim ishte mizëri. Katër-pesë veta në një kthinë të ngushtë dhe me një dush! Të burgosurit e përgatitur për spiunim do të përpiqeshin me çdo çmim të zbulojnë të gjitha ato që nuk kishte pasur sukses UDB; përgjonin çdo lëvizje timen e çdo tentim komunikimi me shokët e qelive tjera dëgjonin me vëmendje çdo fjalë. Kuptohet,

ata në rastin e parë lajmëronin drejtorinë e burgut për çdo gjë. Pastaj pasonte dënimi në qeli të shtruar vetëm me cemento e pa dritare, ku linin me javë të tëra. Në shenjë proteste, ne kalonim në greva totale urie disaditëshe. Por edhe këto vetëflijime nuk përfilleshin. Njëherë më denoncuan se kam kënduar këngë për Shqipërinë, se kam sharë udhëheqësit Kosovarë që i shërbenin Jugosllavisë, se një të burgosuri ia kam dhënë në wc një gazetë me foton e Kalit të Trojës etj., etj.

Si dënim, më lidhën me zinxhirë e më lanë në qelinë pa dritare e me cemento më se 48 orë, gjatë së cilës kohë nuk pranova fare ushqimin. Si dënim pastaj edhe vizitat na i ndalonin për një kohë. Kështu disa muaj me radhë. Kushte tjera të burgut ishin të njëjta si më parë. Tani kisha të drejtë në literaturë, shtyp, vizitë dhe shëtitje të rregullt, kuptohet nëse nuk ma ndihmonte ndonjë denoncim i shtyllave të shoqërisë vetëqeverisëse: si hajdut, vrasës, plaçkitës, dhunues, mashtrues, etj.

Vizitat akoma ishin shumë të shkurtëra dhe nëpërmjet rrjetit metalik, ato nuk zgjasnin më shumë se 5 minuta. Letrat censuroheshin shumë rreptë, kështu që nuk lejonin të dilte asgjë nga çështjet që kanë të bëjnë me hetimet, torturat dhe maltretime të burg.

Pas disa muajsh na transferuan nëpr burgje të ndryshme hetuese të Kosovës. Çdo burg tjetër në Kosovë është për një nuancë më i mirë se ai i Prishtinës se kushtet edhe në këto burgje janë mjaft të vështira. Ishte shpëtim i madh të largoheshim nga burgu i Prishtinës dhe me gëzim të madh e pritëm transferimin.

Çdo njërin prej nesh e çuan në ndonjë burg hetues të Kosovës. Kur na morën për transferim, na i vunë prangat edhe në veturën e policisë "maricë". Unë qeshë vetëm dhe më futën prapa, ku nuk kishte dritare. Ishte e mbyllur hermetikisht me metal e grila". Por tamam që rehatoheshim dhe u adaptoheshim kushteve të reja të burgut dhe vendosim lidhje me familjet tona të cilat na vinin me çdo çmim në vizitë, UDB na transferonte në ndonjë burg tjetër. Nayrisht këto transferime ishin kohëshkurtëra sepse së shpejti do të na transferonin nëpër burgje e kampe të ndryshme të Jugosllavisë.

Një ditë në mëngjes, na mblodhën me "marica" dhe na çuan jashtë Kosovës, tamam si hitlerianët që i degdisnin të burgosurit kahmos. Edhe neve na nisën në drejtim të panjohur. Udhëtuam tërë ditën e tërë natën të lidhur me pranga e të përcjellur me roje te

shumta të armatosura me automatikë. S'kishte kurrëfarë dallimi nga ato që kisha lexuar edhe parë nëpër filma për Luftën e Dytë Botërore, por një të vetmin ndryshim: Gestapoja lajmëronte se kur do të niseshin të burgosurit dhe u jepej mundësia familjeve që t'i vizitonin, ndërsa UDB jugosllave, këtë nuk e bënte. Një dallim tjetër ishte se në LDB këto gjëra i kishte bërë nazizmi hitlerian, kurse tani i bën një shtet i vetëquajtur socialist.

Të nesërmen arritëm në një nga shumë burgjet-kampet në thellësi të Jugosllavisë. Vetëm tani do të mësonim se ku ishim daktisur nga policia fashiste jugosllave. Organet e këtij burg-kampi na pranuan si të ishim kafshë për therretore Ata që na sollën na premtuan: "Këtu do të sillen mirëedhe njerëzisht me juve, vetëm duhet të bëheni të sjellshëm e të dëgjueshëm dhe askush nuk do t'ju prekë me dorë. Prandaj, ju nuk do të qëndroni për shumë kohë këtu, por përkohësisht, sepse ne së shpejti do ta përfundojmë një burg shumë të madh në Kosovë dhe dot'iu tërheqim edhe juve." Na dorëzuan si delet te ujçërit e uritur. Gardianët, serbomëdhenj të zini si futa menjëherë filluan të sillen me ne si me skllevërit në kohe të lashta.

Shumë krime janë bërë në burgjet e Jugosllavisë mbi shqiptarët. Shumë veta janë vrarë e therë me bajoneta gjoja duke ikur, shumë të tjerë janë shkallmuar me dru...Si pasojë e kesaj gjendjeje nëpër burgje kanë plasur shumë kryengritje të të burgosurve shqiptarë, të cilat janë shuar me terror e raprezalle të padëgjuar Kryengritës të tillë ose janë pushkatuar ose janë mbyturnë dru, ose kanë marrë dënime tjera të rënda. Shembuj të tillë ka mjaft, si ai në kapedom (KPD- Kazneno Popravni Dom) të Nishit, Zabella të Pozharevcit, Idrizovë të Shkupit, Spuzh të Titogradit; në Stara Gradishkë, në Lepogllavë etj.

Në kampin Idrizovë u mbytën dy të burgosur shqiptarë me pranga në duar nga policët shovinistë maqedonë, ndërsa të tjerët u sakatuan për tërë jetën nga shqelmat dhe druri gjakatar udbesk, dhe nuk mbeti me kaq, por u dënuan edhe me burgim shumëvjetësh. Kurse gardianët-vrasësit mizorë u dënuan rreth dënime simbolike, thuase kishin sharë dikënd e jo se kishin mbytur mizorisht me dajak e shqelma njerëzit duarlidhur. Në Spuzh të Titogradit, gardianët hapën zjarr në të burgosurit politik shqiptarë, duke plagosur disa sish, e pastaj edhe i dënuan edhe me disa vite burgim. Në Nish policia hapi zjarr kundër të burgosurve shqiptarë duke vrarë e plagosur disa prej tyre. Në Zabella të Pozharevcit, drejtorja e burgut e organizoi masakrën e njohur ndërmjet të burgosurve shqiptarë e

serbë. Epilogu: katër të burgosur serbë të vrarë, shtate te tjerë të plagosur rëndë dhe dhjetra sish te plagosur lehtë. Pas masakrës, katër shqiptarë, te cilët në vetëmbrojtë të domosdoshme u detyruan të vrasin të burgosurit serbë të nxitur nga drejtorja u dënuan me pushkatim.

Çka ta zgjasim më shumë, kur shkurt, nëpër burgjet-kampet e Jugosllavisë bëhen krime e ushtrohet terror ndaj shqiptarëve të burgosur, krime e terror që njeriut i ngjethet trupi vetëm kur i kujton. Meqë kanë dëgjuar për krime të tilla, apo edhe i kanë parë me sytë e tyre, të burgosurit shqiptarë nuk ndiejnë veten për asnjë moment të sigurt në këto kampe.

Duke pasur parasysh këtë dhe traditën e rnoçme të solideritetit të popullit tonë, të burgosurit shqiptarë, në të gjitha burgjet e Jugosllavisë përbëjnë një kompaktësi të fortë e të qëndrueshme dhe, kurdoherë janë të gatshëm të sakrifikojnë çdo gjë për njëri-tjetrin. Këtë unitet të çeliktë organet e burgut dhe UDB nuk mund ta kuptojnë kurrësesi. Përpjekjet e tyre të parreshtura për të thyer këtë solidaritet të shqiptarëve të burgosur, kurrë nuk kanë mundur të japin sukses sepse ne shqiptarëve na karakterizojnë veti te tilla, që duhet të pranojmë, se janë të rralla: krenaria, vetëdija dhe ruajtja e identitetit kombëtar, karakteri i fortë, papërkulshmëria ndaj vështirësive dhe situatave të rënda e të rrezikshme për jetën, besa, solidariteti, etj., bëjnë që ky unitet t'u përballojë me sukses të gjitha dinakërive të UDB-së dhe drejtorive shoviniste të burgjeve.

“

Ironi e viteve '80 të shekullit XX! Të krahasohet kriminel, vrasësi e hajni, dhunuesi e mashtruesi, ai që kishte dhunuar edhe nënën e vet apo edhe fëmijët e tij, me ne të burgosurit politikë! Edhe Hitleri, si shembull tipik i despotizmit e sadizmit politik kishte bërë dallimin dhe klasifikimin e të burgosurve: Vrasësit me vrasës, hajdutët me hajdutë, dhunuesit me dhunues, ndërsa të burgosurit politikë me të burgosur politikë. Pra çdo kategori veç e veç. Kurse në burgjet jugosllave kjo nuk bëhet!

”

NË BURGJET FAMËKËQIJA JUGOSLLAVE

Fillimisht na quan në karantinë (dhoma e pranimit). Aty kishte edhe shumë të burgosur të tjerë. Kishte kriminelë, vrasës, hajdutë, dhunues, mashtrues, të burgosur politikë e çka jo tjetër. Ne, të burgosurve politikë na përzien me këtë llym të llymit të shoqërisë jugosllave. Propaganda e fëlliqur e regjimit kishte bërë të veten: të burgosurit e kombësive tjera ishin të mbushur urrejtje ndaj shqiptarëve, sikur ne të ishim fajtorë për fatkeqësitë e tyre. Nuk kaluan as disa ditë dhe linden grindjet e para me të burgosurit e kombësive tjera dhe të gjitha këto në sajë të punës dhe dorës së drejtpërdrejtë të UDB-së.

Dhe natyrisht nëpër qeli pastaj i mbyllnin vetëm shqiptarët gjoja si shkaktarë! Kështu edhe mua më ra radha të shkoj në qeli gjatë kohës që qëndruam në karantinë, jo për grindje me të burgosurit tjerë, por për bindjet e mia politike.

Ishte një dimër i ftohtë sa s'bëhet, aq sa karcejt e akullit në strehë ishin të gjatë mbi dy metra e të trashë sa këmba. Ashtu në atë të ftohtë gardianët i hiqnin krejt dritaret saherë që në qeli i qonin shqiptarët. Ashtu vepruan edhe me mua. Me pak rroba në trup e në atë të ftohtë, pa pasur në qeli asgjë veç gypit-ëc. Veç grilave edhe karcejt lëshoheshin nga strehët. Gjendjen e një të burgosuri në një situatë të tillë është vështirë ta përshkruash. Veç kësaj as ushqimin nuk e pranoja. Bëja grevë urie.

"Edukata" në këto "shtëpi përmirësuese" siç i quan regjimi këto kasaphane kishte bërë te veten. S'mund të gjeje njeri që në fjalorin e përditshëm të mos përdorte sharje në çdo fjali.

Në mes veti, në vend të përshëndetjeve të zakonshme, ata përdorin të sharat, shumë të shara që s'i kap kalem. Fakt se ne, shqiptarëve nuk na shanin, sepse e dinin se mund të lënë edhe kokën, por një gjë e tillë na bente të pamundur komunikimin me ta. Ata ishin mësuar që në fjalorin e tyre të përdornin në gdo të dytën fjalë një të share. Shanin nënën njëri-tjetrit, babain, gruan, motrën, fëmijët e kë nuk ia shanin njëri-tjetrit, Edhe nënën e vet e shanin, kur donin të vërtetonin saktësinë e asaj që tregonin. Të gjitha keto ata i bënin pa vetëdije, duke menduar se janë gjëra normale, e mbi të gjitha se keto tregonin "civilizim e emancipim". Ndërsa neve na konsideronin primitivë e të prapambetur.

Kam përshtypjen se një degjenerim i tillë kishte lëshuar rrënjë të thella në të gjitha shtresat e popullsisë së këtyre anëve. Edhe intelektualët në fjalorin e tyre të përditshëm, sikur të hanin bukë, kishin të sharat në majë të gjuhës. Edhe kur bisedonin këta njerëz vetëm një temë kishin: prostitutat dhe dëfrimet e shfrenuara dhe s'kishin ç'të bisedonin tjetër, gazetat e përditshme, edhe pse informativo-politike, nuk mund të dalin pa pasur ndonjë femër lakuriqe. Politika jugosllave as s'mund të mendohet pa rolin e rëndësishëm që luan në të pornografia. Të shumta janë revistat që u kushtohen krejtësisht pornografisë dhe dëfrimeve. Edhe muzika e tyre i kushtohet "dashurisë" dhe dëfrimeve të shfrenuara, kur mbizotërojnë stilet dhe përmbajtja më dekadente e muzikës degjeneruese. Televizioni për çdo natë jep filma pornografik. Nga do ta kthesh kokën, në çdo vend të dukshëm të burgut, në dhomë, në vendin e punës, etj., do të shohësh vetëm fotografi të femrave lakuriqe. Kjo, natyrisht i ka qëllimet e veta: të preokupohet i burgosuri vetëm me instiktet më të ulëta, të demoralizohet dhe ti topitet çdo ndjenjë e pastër njerëzore. Përveç pornografisë, dëfrimeve të shfrenuara dekadente dhe sportit vështirë të gjejsh njerëz në burgjet jugosllave që interesohen për rrejdhat e jetës, për kulturën, apo për ngjarjet politike. Përrashtim bëjnë të burgosurit politikë! Kjo edhe është arsyeja kryesore që këta të burgosur edhe nuk dinë të mendojë diç tjetër.

Një presioni të tillë të të gjitha mediumeve si gazetave, revistave, radios, televizionit, filmi, xhep-romanit, etj vetëm një pjesë e vogël, simbolike e rinisë jugosllave mund ti shpëtojë. Këtu edhe qëndron një ndër shkaqet që rinia dhe klasa punëtore jugosllave të mos ngrisin akoma në mënyrë të organizuar kokën kundër politikës antipopullore të regjimit.

Në karantinë na mbajtën një muaj, me një regjim të posaçëm. Tani më nuk kishim emra

dhe as që vlenin emrat, por kishim numrat, numrat e amzës. Edhe në kampet hitleriane të përqëndrimit njerëzit ishin numra. Jam i bindur se kjo nuk është një koinçidencë e rastit. Brenda kësaj kohe na i bënë kontrollimet e ndryshme mjekësore-psikologjike. Të gjitha këto gjoja për caktimin në vende përkatëse të punës. Por realiteti ishte krejt tjetër. Kontrollimet mjekësore, testimet psikologjike, bisedat me psikologë e “punëtorë social” ishin vetëm formalitete. Kishte të burgosur shqiptarë që ishin të sëmurë rëndë, ndonjë kishte barkun përplot ulqera, por “mjekët” thoshin se ne ishim të aftë edhe për punët më të rënda fizike. Dhe natyrisht se punë të tilla edhe na caktoheshin. Tamam si në kampet hitleriane të përqëndrimit. Sa e sa vepra e tregime kisha lexuar për gjëra të tilla e tani të gjitha këto i përjetoja me kurrizin tim në Jugosllavinë titiste. Shtet që kishte kaluar një periudhë afro dyzetvjeçare të ndërtimit të vetëquajtur socialist-vetëqeverisës. Hitlerianët i ndiqnin ku ishin e ku s’ishin hebretë, ndërsa jugosllavët i kanë ndjekur dhe vazhdojnë i ndjekin shqiptarët. Me qindra mijëra i shpërngulën me dhunë për Turqi, ndërsa me dhjetëra mijëra po i tretin burgjeve anë e mbanë Jugosllavisë.

Punët më të rënda në kampet naziste ua caktonin hebretë, në burgjet e Jugosllavisë punët e tilla na caktojnë të burgosurve shqiptarë, veçanërisht atyre politikë. Gjatë kohës që na mbajtën në karantinë, organet e burgut përmes të ashtuquajturve referntë-educatorë (!!!) që në fakt ishin udbashë, edhe drejtëpërdrejt drejtori i burgut, zëvendësi i tij dhe komandanti i gardianëve na bënë një presion të çuditshëm dhe po aq të poshtë për të na detyruar që letërkëmbimin dhe vizitat ti bënim në gjuhën serbishte.

Ishte ky shovenizëm serbomadhi që edhe haptas shprehte urrejtjen ndaj gjuhës sonë shqipe. Ishte ky një atak në dinjitetin tonë kombëtar. Por një presioni të tillë dhe provokimeve të përditshme u bëmë ballë me sukses. Qëllimi i këtyre presioneve ishte topitja e ndjenjave tona kombëtare, humbja e gjuhës amtare dhe asimilimi i plotë. Për këtë do të flas më poshtë.

Pas një muaji qëndrimi në karantinë, na thirrën një nga një te drejtori i burgut, i cili na caktoi pavijonin dhe numrin e dhomës e kuptohet edhe vendin e punës që na kishin përgatitur. Punët më të vështira ishin caktuar për ne; një politikë të tilla antishqiptare as karagjorgjeviqët nuk kanë ndjekur siç ndjekin titistët dhe pastitistët. Një gjë të tillë qytetarët e Evropës e kanë vështirë ta kuptojnë, pasi tani përdorin metodat më perfide të

zhdukjes, asimilimit dhe shfarosjes së popullit tonë. Kushtetuta formalisht, de jure, na i njeh të gjitha të drejtat si çdo qytetari tjetër, por në realitet ndodhë krejtësisht e kundërta. Sepse në çdo hap, të gjitha organet e pushtetit veprojnë sistematikisht, duke vënë në shërbim metodat më brutale në shtypjen, shfrytëzimin dhe diskriminimin kombëtar të popullit tonë. Një të drejtë të tillë kishin edhe drejtoritë e burgjeve jugosllave, nëpër të cilat dergjen me dekada të tëra me mijëra të rinjë shqiptarë dhe diskriminohen e keqtrajtohen me metodat më fashiste, për të cilat do ua kishin lakmi edhe regjimet më antipopullore në botë.

Organet e burgjeve jugosllave kanë një metodologji të psoaçme pune me të burgosurit shqiptarë e veçanërisht me ata politikë. Kur na caktuan pavijonet, dhomat dhe punën, kuptuam se na kishin shpërndarë dhe na kishin bërë pikë e pesë. Asnjë nga ne nuk e kishin lënë me ndonjë shok në dhomë. Por ne shumë shpejt mundëm të shoqërohemi dhe të lidhim miqësi mes veti edhe nëse nuk ishim njohur kurrë më parë. Këtë e bënte ideali dhe çështja e njëjtë për të cilin luftojmë. Kompaktësia dhe solidariteti bëhej shumë shpejt, menjëherë pas bisedave të para parulla "Një për të gjithë, të gjithë për një" është moto e jetës së të burgosurve politikë shqiptarë anë e mbanë Jugosllavisë.

Mu kjo është çështja që më së shumti u nxjerr kokëçarje drejtorive të burgjeve jugosllave. Kështu na dërguan nëpër dhoma që kishin edhe nga 150 shtretër. Taman si në shtalla kuajsh. Shtretërit dykatësh ishin radhitur në disa kolona. Aty flihej, aty rrihej gjatë ditës, aty ndokush hante e pinte, me një derë të vetme, ishte e ndarë tualeti dhe lavabotë (lajtorja). Ç'mizerie! Kështu na bashkuan me kriminelë, mashtrues, vrasës, hajdutë e dhunues... Sa të paturpshëm ishin ata të drejtorisë së burgut, sepse personeli i saj na konsideronte të njëjtë. Ligësia e tyre arrinte gjer atje sa edhe të na thonë: "Të gjithë për neve jeni të njëjtë dhe si të tillë iu njef edhe rendi shtëpiak"! Ironi e viteve '80 të shekullit XX! Të krahasohet kriminel, vrasësi e hajni, dhunuesi e mashtruesi, ai që kishte dhunuar edhe nënën e vet apo edhe fëmijët e tij, me ne të burgosurit politikë! Edhe Hitleri, si shembull tipik i despotizmit e sadizmit politik kishte bërë dallimin dhe klasifikimin e të burgosurve:

Vrasësit me vrasës, hajdutët me hajdutë, dhunuesit me dhunues, ndërsa të burgosurit politikë me të burgosur politikë. Pra çdo kategori veç e veç. Kurse në burgjet jugosllave kjo nuk bëhet!

Ishte shumë e çuditshme se në mes të burgosurve politikë të kombësive tjera nuk kishte kurrëfarë uniteti e solidariteti mes tyre. Drejtoria e burgut ia kishte arritur qëllimit që të burgosurit politikë, duke i shpërndarë nëpër dhoma të ndryshme dhe duke i përzier me lloj-lloj kriminelit t'u topis ndjenjat e solidaritetit e të qëndresës së organizuar. Pastaj drejtoria e burgut përdorte edhe presionet direkte e kërcënimet, që secili të shikojë vetëm e vetëm punën e tij.

Por të burgosurit politikë shqiptarë, që konsideroheshin si kategori e veçantë, pra më të rrezikshmit, këtyre presioneve e kërcënimeve u përgjigjeshin dhe iu kundërviheshin me forcën e unitetit dhe solidaritetit që rritej e çelikosej, sa me të vrazhda që të bëheheshin kërcënimet e ndëshkimet.

Një i burgosur politik shqiptar po qe se dërgohej në qeli, drejtoria e burgut ishte e detyruar të dërgonte në qeli të gjithë të burgosurit e tjerë politikë shqiptarë, sepse të gjithë përnjëherë e ndërprisnin punën dhe shpallnin grevë urie duke u solidarizuar me atë që gjendej në qeli. Ndërsa kjo gjë drejtorisë nuk i pëlqente dhe për të mos na lënë mes të burgosurve duke bërë grevë dhe për të mos i influencuar edhe të tjerët na dërgonin të gjithëve nëpër qeli. Shpesh herë kemi bërë grevë urie nga 7, 8, 10 e 12 ditë nga 15 e 20 ditë dhe nga drejtoria e burgut nuk vinte askush për të na vizituar. Kështu na ndodhte shpesh, gati në çdo disa muaj.

Kushtet e burgut për ne, të burgosurit shqiptarë, e sidomos për të burgosurit politikë ishin më se të vështira. Ushqimi ishte shumë i dobët për punën e rëndë që bënin të burgosurit. Por për ne shqiptarët ishte edhe më i dobët, për arsye se të burgosurve tjerë mund t'u vinin më shpesh në vizita dhe me anë të paketave e plotësonin sado kudo mungesën e ushqimit të burgut. Por ne shqiptarëve që na kishin daktisur me mijëra kilometra larg familjeve tona të varfëra, të afërmit tanë nuk kishin mundësi të na vizitojnë shpesh. Letërkëmbimin me familjet e benim në gjuhën arntare, prandaj për inat na i vononin letrat edhe me muaj të tërë, ndërsa shumicën as që na i jepnin, e as që i dërgonin. Vizitat edhe pse të rralla, ato ishin shumë të mërzitshme për ne. Për të burgosurit tjerë nuk kishte nevojë të qëndrojnë asnjë gardian në vizitë, por vetëm për ne, e posaqërisht për ne të burgosurit politikë nga Kosova kishte tretman të posaqëm në vizitë. Përveç gardianëve, aty gjendej doemos edhe përkthyesi udbash. Poshtëri më të madhe

s'ke ku gjen. Vizitat tona i mbanin në kthina të veçanta, sigurisht të përgjuara me mikrofonë... Familjet tona udhëtonin me ditë të tëra për të na ardhur në vizitë dhe kur vinin i pritnin situatat më torturuese. I linin të prisnin me orë të tëra. Të gjitha ato shpenzime edhe pranë varfërisë, të gjitha ato mundime në rrugë kaq të gjatë, dhe në fund nuk arrinim as të shifemi si duhet dhe as të bisedonim e të pyesnim për të afërmit e farefisin!

Biblioteka ishte përplot me libra në gjuhën amtare të të burgosurve tjerë dhe s'kishte nevojë të blenin asnjë libër. Shtypin e përditshëm ata e përcillnin në gjuhën amtare që ua siguronte drejtoria. Për ne shqiptarët këto ishin vetëm ëndrra. Libra për ne dhe bibliotekë në gjuhën shqipe nuk kishte dhe as që pranonin të na sillnin. Na thoshin: "Lexoni serbisht, keni libra sa të doni në bibliotekë"! Kërkonim të na sigurohej shtypi i përditshëm kosovar me shpenzimet e burgut e ata na thosin: "S'mund ta shkatërrojmë ekonominë jugosllave duke u blerë edhe juve gazeta, lexojeni "Politikën", siç e lexojnë të gjithë!" Me një gazetë të shkatërrohet ekonomia e një shteti! Arsye se jo mahi!

Atëherë, kur shihnim se drejtoria e burgut nuk donte të dëgjojë për kërkesat tona, ne kërkonim me shkrim nga organet më të larta shtetërore plotësimin e kushteve dhe të drejtave që na i garatonte kushtetuta jugosllave. Si përgjigje në kërkesat tona me shkrim, që i nënshkruanim të gjithë ne të burgosurit politikë shqiptarë, të njëjtën ditë na dërgonin nëpër qeli. Aty ne ia fillonim grevës së urisë. Pas dhjetë ditësh greve na merrnin një nga një dhe ne prezencë të përfaqësuesit të jurisprudencës republikane na dërgonin me nga 6 muaj apo një vit izolim-vetmim. Menjëherë pastaj na hipnin nëpër "marica" dhe të lidhur me pranga na dërgonin në ndonjërin prej burgjeve të shumëta hetuese, ku ne mbanim dënimin në qeli.

PËRFUNDIM

Përveç me ndonjë të burgosuri politikë të kombësive tjera, ne nuk flsinin thua me askënd, as nuk shoqëroheshim dhe as që shëtisim me ta. Kjo gjë e mundonte çdo drejtori të burgut jugosllav dhe posaçërisht UDB-në. Çuditëshin se si mund të qëndronim të vetmuar në mesin e atyre të burgosurve, se si nuk dilnim të luanim shah me askënd, as të shëtisim, pos me të burgosurit shqiptarë. Kishim presione të përditshme që të shoqërohemi, të luajmë shah, të shëtisim edhe me të burgosurit tjerë dhe të mos "vetizohemi", se edhe të tjerët na qenkëshin njerëz. Sa të çuditshëm që janë shovinistët jugosllavë! Krimineli, vrasësi, ai që kishte dhunuar nënën e tij apo bijat e veta, të jenë njerëz! Por, ne, keto presione i kalonim me gjakftohtësi dhe vazhdonim ta organizojmë jetën e atyshme sipas zakoneve tona.

Në burgjet e Jugosllavisë së vjetër, të Jugosllavisë së Karagjorgjeviqëve, të burgosurit politikë kishin kushte më të mira se sot, pas gjysmë shekulli. Atëherë të burgosurit politikë janë marrë edhe me përkthime, përkthime të veprave të autorëve të huaj, kurse tani ne nuk guxojmë të shkruajmë asnjë fjalë të vetme. Shpesh na bëhen bastisje dhe çdo fjalë që shkruhet na e marrin dhe kurrë nuk na e kthejnë. Nga burgju nuk mund të nxjerrim asgjë të shkruar. Kjo vlen për të burgosurit politikë shqiptarë posaçërisht. Me qëndrimin e vendosur e konsekuent të të burgosurve shqiptarë, e të atyre politikë sidomos patëm fituar një simpati të dukshme dhe një besim të patundur të të burgosurit e kombësive tjera. Nga të burgosurit shqiptarë ishte vështirë që drejtoria e kampit të përfitonte dikë e të bënte ndonjë spiun. Prandaj edhe të burgosurit e kombësive tjera kurrë nuk frikoheshin nga ne se do t'u vijë diçka e ligë. Nga ky qëndrim yni dhe nga besimi që kishin në ne, nga

gatishmëria jonë për të ndihmuar këndo, shpesh të burgosurit e kombësive tjera shprehnin gatishmërinë për të na ndihmuar me diç apo për të na bërë ndonjë shërbim.

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë, mund të nxirret si përfundim se UDB, si aparat në shërbim të një politike gjakatare e banditeske jugosllave, me të gjitha drejtoritë e saj burgjeve dhe degët e shërbimet e saj mbetet përgjithmonë gjakpirëse e të gjithë popujve dhe do të dështojë me turp. Qëndrimi ynë i pëthyeshëm edhe në këto kushte kaq të vështira, përbën një grusht të fuqishëm për fundin e pashmangshëm që e pret këtë sistem të kalbur policor. Duke pasur shpresën e besimin se ky përshkrim i një të burgosuri politik shqiptar, do të arijë në vendin e duhur, jam i sigurtë që sado pak do ta njoftojë opinionin shqiptar e ndërkombëtar për padrejtësitë, diskriminimin, maltretimet dhe terrorin ndaj liridashësve shqiptarë nga sistemi i korruptuar, gjakatar, shovinist e policor jugosllav. Unë si i burgosur politik shqiptar, në emër të të gjithë shokëve të mi të vuajtjeve, ngris zërin kundër politikës fashiste e terrosiste të Beogradit, duke e akuzuar botërisht për politikën e gjenocidit ndaj popullit shqiptar, i cili jeton në trojet e veta të aneksuara përdhunisht nga Jugosllavia.

Në fund, thërras tërë opinionin progresiv ndërkombëtar, t'i kundërvihet politikës terrsiste jugosllave që ushtrohet kundër popullit liridashës shqiptar në Jugosllavi. Ftoj organizatat politike dhe individët përparimtarë të të gjitha kontinenteve që të përkrahin moralisht e materialisht Lëvizjen Çlirimtare të Kosovës.

QËNDRESA

REXHEP MALAJ

KUJTIME NGA BURGU

QËNDRESA

REXHEP MALAJ

KUJTIME NGA BURGJ